

EDUARD SHEHI
RUDENC RUKA
EDUART CAKA

SHËNIME MBI FORTIFIKIMET E DURRËSIT NË PERIU DHËN OSMANE

Qyteti i Durrësit paraqet një nga qendrat më të rëndësishme të arkeologjisë shqiptare dhe mesdhetare. Historia e tij komplekse nis që nga prehistoria e vonë ose në periudhën e hekurit e deri në ditët e sotme. Sidoqoftë fortifikimet e periudhës osmane të qytetit dhe në tërësi kjo periudhë, kanë tërhequr rrallë vëmendjen e studiuesve sesa ato të periudhave më të hershme historike. Ky qëndrim mund të jetë i lidhur me prirjen e përgjithshme të historiografisë shqiptare që e shikonte periudhën osmane në Shqipëri nën një këndvështrim shpërfillës. Këto qëndrime mund të jenë të lidhura pjesërisht me pozicionin e izoluar të Shqipërisë gjatë periudhës komuniste, kohë në të cilën, e huaja shihej si armiqësore dhe pjesërisht nga ngjarje të afërta historike që lidhen me shpalljen e pavarësisë nga perandoria. Si rrjedhim, edhe aspekte të ndryshme të kësaj periudhe, si p.sh. fortifikimet, u janë shmangur hulumtimeve sistematike apo mund t'u jenë veshur periudhave më të hershme historike. Shembulli më simbolik për Durrësin, dhe jo vetëm, është datimi i “torrës veneciane” të qytetit¹, e cila tashmë mendohet se i takon periudhës osmane². Ky qëndrim ka gjetur “mbështetje” të pavullnetshme edhe në nivelin studimor evropian. Nga njëra anë, kërkuesit shqiptarë duke u mbështetur në shkallën e njohurive të historiografisë evropiane, i kanë përdorur

¹ Leon Rey, “Les remparts de Durazzo”, *Albania: Revue d'archeologie, d'histoire, d'art et des sciences appliqués en Albanie et dans les Balkans*, Milano-Roma: Casa editrice d'arte Bestetti e Tumminelli. Fasc. I, 1925, f. 33-48; Gjerak Karaiskaj, Apollon Baçe, “Kalaja e Durrësit dhe fortifikimet përreth në antikitetin e vonë”, *Monumentet*, nr. 9, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë: 1975, f. 3-33.

² Camillo Praschniker, Arnold Schober, *Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien: Рипол Классик, 1919, f. 34; Machiel Kiel, *Ottoman Architecture of Albania (1389-1912)*, Research Centre for Islamic History, Art and Culture, Istanbul: 1990, f. 98.

datimet e dhëna prej tyre për të mbështetur studimet e veta, si në rastin e datimit të kullave të Selanikut, të cilat më pas kanë rezultuar të jenë ndërtime osmane³. Nga ana tjetër, po këta studiues vendas nuk kanë ndjekur ritmin e kërkimeve evropiane, duke mos u përditësuar me gjetjet më të fundit dhe ndryshimet e datimeve të strukturave të marra fillimisht si pikë referimi⁴. Vëmendja mbi qytetin e periudhës osmane ka qenë shumë e pakët, pothuaj asgjë nuk njihet nga kjo periudhë mbi Durrësin.

Rezultatet e punës kërkimore në terren kanë shtruar nevojën për rishikime thelbësore të koncepteve funksionale, datuese dhe të evolucionit të fortifikimeve të qytetit të Durrësit. Gjetjet e reja nxorën në pah një seri mospërputhesh në krahasim me përrshkrimet tradicionale që fillonin nga shek. XIX⁵, vazhdonin më pas në vitet 20 të shek. XX⁶ dhe deri në vitet e fundit⁷. Këto studime, me gjithë të rejtat që sillnin, nuk hidhnin dyshime mbi vazhdimësinë e fortifikimeve nga Antikiteti deri në Mesjetë pothuaj në po atë perimetër që ishte paraqitur për herë të parë nga arkeologët francezë L. Heuzey dhe A. Daumet në botimin e vitit 1876. Gjetjet e dy viteve të fundit ishin sugjeruese për të propozuar datime të reja për një seri elementësh mbrojtës, si pjesë e fortifikimeve të

³ Për «Kullën e Bardhë» është zbuluar mbishkrimi, i cili qëndronte mbi hyrjen e saj deri në vitin 1912. Në të dëshmohej ndërtimi me urdhër të sulltan Sulejmanit në vitin 942, që korrespondon në mes të datave 12 qershor 1535 dhe 19 qershor 1536. Shih Machiel Kiel, "A Note on the Exact Date of Construction of the White Tower of Thessaloniki", *Balkan Studies*, 14, Thessaloniki: 1973, f. 325-357.

⁴ M. Kiel, *Ottoman Architecture of Albania...*, f. 97-98.

⁵ Leon Heuzey, Honore Daumet, *Mission archéologique de Macédoine*, vol. 2, texte et planches, Paris: Firmin-Didot, 1876, f. 349-392.

⁶ C. Praschniker, A. Schober, *Archäologische Forschungen...*, f. 32-46; L. Rey, "Les remparts de Durazzo...", f. 33-48.

⁷ Gj. Karaïskaj, A. Baçe, *Kalaja e Durrësit...*, f. 23; Gjerak Karaïskaj, "Kalaja e Durrësit në mesjetë", *Monumentet*, nr.13, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë: 1977, f. 29-54; Adam Gutteridge, Afrim Hoti, Henri R. Hurst, "The walled town of Dyrrachium (Durrës): settlement and dynamics", *Journal of Roman Archaeology*, no. 14, vol. I, Cambridge: 2001, f. 391- 410; Adam Gutteridge, "Cultural geographies and 'The ambition of Latin Europe'. The city of Durrës and its fortifications c. 400-c. 1501", *Archeologia medievale*, 30, Firenze: 2003, f. 19-65; Eduard Shehi, "Contributo sulla topografia di Dyrrachium", *Journal of Ancient Topography*, Atti del VI Congresso di Topografia Antica "La città antica in Italia" (Roma, 21-22 Marzo 2007). Parte I, Mario Congedo (ed.), XVII, Roma: 2007, f. 162-164.

qytetit⁸. Nga ana tjetër, që të tilla interpretime të kapërcejnë nga faza e “hamendësimeve të përkohshme” në pozicionin e një “propozimi” të pranuar gjerësisht nga studiuesit për periudhën në fjalë, nevojitet që ato të mbështeten në dokumente arkivore osmane. Rrjedhimisht, në këtë artikull do të parashtrijmë nivelin e njohurive të arritura deri më tani nga fusha e arkeologjisë dhe e historisë, duke i krahasuar dhe plotësuar me përshkrimet që kemi arritur të vjelim rishtazi nga dokumentacioni arkivor osman dhe perëndimor. Për këtë arsye, fillimisht do të paraqesim një përmbledhje historike të gjendjes së qytetit bazuar në një seri dokumentesh me theks të veçantë për sa i përket fortifikimeve, ku në veçanti spikasim, me detajet që paraqesin, tri harta osmane të shek. XIX. Tek këto dokumente arkivore kemi mundur të identifikojmë të dhëna të sakta mbi disa nga strukturat që kemi në trajtim. Në mbyllje do të ndërthurim të gjitha këto të dhëna, duke paraqitur një pamje të re të fortifikimeve të periudhës osmane në Durrës, duke u bazuar jo vetëm në studimet e vjetra dhe të mirënjohura, por edhe në të dhënat më të fundit. Kemi përjashtuar nga ky studim të gjitha ato ndërtesa të periudhës osmane të cilat nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fortifikimet e kësaj periudhe. Trajtimi i tyre do të kërkonte një hapësirë më të gjerë botimi, e cila është përtej qëllimeve të këtij artikulli. Për arsye të ndihmesës në studimin e evolucionit të fortifikimeve kemi trajtuar vetëm ngrehinat kryesore, ushtarake, administrative si edhe sistemin rrugor të lidhura ngushtësisht me të.

Këtë artikull e konsiderojmë si një hap të parë dhe provë, ku ndërthuren aspektet arkeologjike me ato dokumentare për trajtimin e periudhës osmane nën një dritë të re por kurrsesi shterues. Përtej praktikave të zakonshme studimore ku disiplina e arkeologjisë dhe historisë kanë hulumtuar në mënyrë të pabashkërenduar si dhe që të arrihej në rezultate sa më objektive, bashkëpunimi ishte i domosdoshëm.

⁸ Eduard Shehi, Eda Çekrezi, Ergys Hasa, Klodian Velo, Catherine Abadie-Reynal, “Rezultatet e sondazheve arkeologjike të realizuara para hyrjes së portit të Durrësit”, *Candavia*, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 2017, f. 49-79; Eduard Shehi, “Rishikim mbi topografinë e Durrësit antik në dritën e të dhënave të reja arkeologjiko-historike”, *Iliria*, XLI, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 2017, f. 229-289; Catherine Abadie-Reynal, Arnaud Lefebvre, Eduard Shehi, Brikena Shkodra-Rrugia, “Topografia e Epidamne-Dyrrachion. Fushata e vitit 2017”, *Candavia* 7, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 2017, f. 193-199.

1. Dokumentacioni arkivor

Të dhëna mbi qytetin e Durrësit përgjatë periudhës osmane gjenden të copëtuara në botime të ndryshme, përgjithësuese historike⁹, në trajtimin e aspekteve të ngushta të karaktereve të ndryshme¹⁰, ose me të dhëna nga burime arkivore¹¹. Kjo është edhe arsyeja se përse studiuesit sot nuk kanë në duar një panoramë të qartë të historisë së qytetit dhe të fazave të zhvillimit demografik, ekonomik e kulturor që ky qytet i rëndësishëm përjetoi që nga pushtimi osman në fillimin e shek. XVI e deri në fillimet e shek. XX. Në vazhdim do të paraqesim një përmbledhje historike bazuar tek dokumentacioni arkivor pikërisht për këtë periudhë. Synimi ynë nuk lidhet me detajimin e historisë së qytetit por me paraqitjen e një pamjeje të përgjithshme, e cila na shërben në kuptimin më të qartë të evolucionit të fortifikimeve.

Durrësi kaloi nën sundimin osman pas një periudhe të gjatë sulmesh dhe një qëndrese gjithmonë e më të dobët nga banorët e fundit të tij dhe nga administrata e fundit venedikase. Një kronikë të përmbledhur, por shumë domethënëse, mbi gjendjen e qytetit dhe të fortifikimeve të tij në dekadat e fundit të administrimit venedikas e hasim tek ditarët e Marino Sanutos¹². Një imazh përmbledhës të këtyre momenteve e gjejmë tek dy botime, realizuar nga J.O.Schmitt¹³ dhe nga H.J.Kissling¹⁴. Në pak rreshta mund të themi se qyteti gjendej në një situatë të mjeruar si pasojë

⁹ Për më shumë shih *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Illirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002.

¹⁰ Të tilla trajtime kanë pasur synime të ndryshme, si p.sh. të lidhura me anën ekonomike të tregtisë dhe përdorimit të portit, apo aspektet politike të luftës së popullit shqiptar për shkëputje nga Perandoria Osmane. Duke qenë se të tillë artikuj janë disa, nuk po i rreshtojmë këtu, duke mos qenë ndihmesë direkt për synimin tonë.

¹¹ Këtu mund të përmendim botimet me disa vëllime të dokumenteve të marra nga arkivat e huaja, përkthyer dhe organizuar sipas shekujve përkatës, botuar nga Instituti i Historisë.

¹² Përfshijnë periudhën mes viteve 1496-1533, botuar në 58 volume, *I diarii di Marino Sanuto*, vol. I-LVIII, Venezia: 1879-1903.

¹³ Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike 1392-1479*, Tiranë: Fjala, 2014, f. 516-526.

¹⁴ Hannah J. Kissling, "Zur Eroberung von Durazzo durch die Türken (1501)", *Studia Albanica Monacensia. In memoriam Georgii Castriotae Scandergei 1468-1968*, München: R. Trofenik, 1969, f. 23-31.

e një kombinimi fatkeq të ndryshimeve gjeomorfologjike me kushtet historike. Ndryshimet gjeomorfologjike kishin rezultuar në mbylljen e lagunës duke e kthyer gradualisht në kënetë apo moçalishte. Ky shndërrim kishte krijuar një situatë të pafavorshme për jetesën në qytet¹⁵, si pasojë e së cilës kënetë ishte kthyer në një qendër sëmundjesh, veçanërisht të malaries, duke i dhënë kështu një goditje të fortë Durrësit¹⁶. Paralelisht, duket se ka shkuar edhe mbushja graduale e bregut, duke vështirësuar ankorimin e anijeve me tonazh të madh pranë skelës/skelave të qytetit¹⁷. Situata historike që po kalonte Gadishulli Ballkanik ishte bërë shumë e vështirë, veçanërisht si pasojë e zgjerimit të vazhdueshëm të Perandorisë Osmane. Vetë Durrësi ishte sulmuar për herë të parë në vitin 1387¹⁸. Që nga kjo kohë, me sulme të drejtpërdrejta apo indirekte, nëpërmjet vështirësive ekonomike apo duke i ndërprerë shkëmbimet tregtare me prapatokën, qyteti do të ishte vazhdimisht nën trysni. Si rezultat, pati një braktisje graduale të Durrësit nga banorët. Kulmin e tij, kjo braktisje masive, e pati në fundin e shek. XV. Fillimi i

¹⁵ Vizitorë dhe funksionarë perëndimorë që e kanë vizituar qytetin gjatë shek. XVII-XVIII theksojnë se malarja ishte njëra ndër sëmundjet më të përhapura këtu. Për më shumë të dhëna mbi klimën e Durrësit në këtë periudhë shih Evliya Çelebi, *Seyahatname*, c. VIII, Orhaniye Matbaası, İstanbul: 1928, f. 711; Machiel Kiel, “Dıraç”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, c. IX, İstanbul: 1994, f. 523; Peter Bartl, *Albania Sacra. Geistliche Visitationsberichte aus Albanien. 2: Erzdiözese Durazzo*. Harrassowitz Verlag-Wiesbaden: 2011.

¹⁶ Shih Marin Sanuto, *I diarii*, vol. II-III, Venezia: 1879, 1880, për ngjarjet që ndodhën gjatë viteve 1499-1501.

¹⁷ G. von Hahn, *Albanesische Studien: nebst 1 Karte und andern artistischen Beilagen*, Mauke, Jena: 1854, f. 74-78; L. Heuzey, H. Daumet, *Mission archéologique...*, f. 349-350, f. 353; C. Praschniker, A. Schober, *Archäologische Forschungen...*, f. 39. Për një aktual të situatës shih. A. Gutteridge, “Cultural geographies...”, f. 54-58. Për përshkrime gjeografike të lidhura me synimet tregtare dhe përdorimin e portit shih: John Dun Gardner, *The Ionian Islands in relation to Greece. With suggestions for advancing our trade with the Turkish countries of the Adriatic, and the Danube*, second edition, London: 1859, f. 86-87; David Urquhart, *Turkey and its resources: its municipal organization and free trade; The state and prospects of English Commerce in the east, the New Administration of Greece, its revenue and National Possessions*, London: 1833, f. 198-202; John Murray, *Handbook for travellers in Greece: describing the Ionian islands, the Kingdom of Greece, the island of the Aegean sea, with Albania, Thessaly, and Macedonia*, London: 1854, f. 400.

¹⁸ Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, ed., vol. II, München-Palermo-Milano: 1967, nr. 332. [më tej: AAV]

shek. XVI e gjeti Durrësin të rrënuar dhe braktisur. Burimet arkivore na dëshmojnë se, nga tetori 1500 deri në prill të vitit 1501, qyteti mund të mbante nën armë vetëm 200 vetë, të moshave të ndryshme¹⁹. Kërkesa e banorëve drejtuar administratës politike dhe ushtarake venedikase për t'ju sjellë në ndihmë së paku 40 stratiotë, mori përgjigje negative²⁰. Nga përlllogaritje të përafërta, shifra prej 200 vetash nën armë mund të përkthehet në një numër banorësh jo më shumë se 1.000 vetë në këtë periudhë, brenda mureve të qytetit.

Përkundrejt këshillave të vlefshme të ushtarakëve venedikas, të cilët kishin propozuar disa herë ndërmarrjen e masave të tilla që mund të ndikonin në mbrojtjen afatgjatë të qytetit²¹, administrata qendrore në Venedik nuk ndërmori pothuaj asnjëherë investime serioze. Shprehja më e mirë mbi konceptin që kishte kjo administratë për ruajtjen e kontrollit mbi Durrësin ishte shprehja e Malipiero-s "*La Signoria soleva custodirla con poco spesa, per la commodità de porto*"²².

Pas disa sulmesh të pasuksesshme, osmanët përfituan nga një verë e nxehtë, e cila kishte tharë pothuaj tërësisht kënetën, për të sulmuar dhe pushtuar Durrësin, më 17 gusht 1501²³.

Pas pushtimit osmanët ndërmorën masa të menjëhershme për të përforcuar fortifikimet e qytetit. Kështu, në një relacion venedikas të tetorit 1502, përshkruhen shkurtimisht punimet e ndërmarra nga osmanët: "*kanë fillue të bajnë themelet në mes të qytetit ku duen me çue një mur dhe me e zvogëlue qytetin, dhe aty n'anë të detit ku ishin dy topa, tashti janë vendos shtatë topa, si thuhet shtatë pëllambësh secili*"²⁴. Ky

¹⁹ Marin Sanuto, *I diarii*, vol. III, a cura di G. Berchet, Venezia: MDCCCLXXIX, kol. 943-944; Marin Sanuto, *I diarii*, vol. IV, a cura di Nicolo Barozzi, Venezia: MDCCCLXXX, kol. 15-16.

²⁰ M. Sanuto, *I diarii...*, IV, kol. 15-16.

²¹ O. Schmitt, *Arbëria Venedike...*, f. 497-501.

²² Domenico Malipiero, *Annali Veneti dall'anno 1457 al 1500*, *Archivio Storico Italiano* 7, Venice: Vieuvsseux, 1843, f. 94.

²³ M. Sanuto, *I diarii...*, vol. IV, f. 91, 104-105; *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV. Burime osmane*, përgatiti për shtyp Selami Pulaha, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1968, f. 125, 178-182; Për një analizë të pushtimit shih. H. Kissling, "Zur Eroberung von Durazzo...", f. 23-31.

²⁴ Injac Zamputi, "Kontribut për historinë e Shqipnisë bregdetare në fillim të shekullit të XVI-të", *Studime Historike*, nr. 1, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1964, f. 123.

zvogëlim i qytetit përmendet edhe nga burimet osmane. Idris Bitlisi, i cili e ka përfunduar realizimin e veprës së tij në vitin 1505, shkruante “...muret origjinalë mund të reduktoheshin gjer në një të tretën që kështu [qyteti] të mund të mbahej e të mbrohej me pak ushtarë...; Meqënëse pranë murit që ndante [tashti] një të tretën e veçuar për fortesë kishte material ndërtues si gurë të punuar etj., që gjendeshin në themelet e vjetër [të fortesës], u sollën mjeshtrë të zotë ndërtimi nga të gjitha viset e Rumelisë, gjithashtu si shpërblim për ustallarët u harxhua nga arka një shumë prej dhjetë herë nga njëqindmijë akçe rumi”²⁵.

Disa detaje mbi qytetin, për periudhën e paspushtimit, jepen nga udhëtari dhe kronikani osman i shek. XVII, Evliya Çelebi. Ai shkruan se ndërhyrjet ndërtimore në kala ishin realizuar përgjatë periudhës së sundimit të Bajezidit II. Sipas tij, nisur nga numri i vogël i forcave mbrojtëse të kalasë dhe nga rreziku i një sulmi që mund të vinte nga ana e detit, në kohën e Bajezidit II, pikërisht në anën lindore të kalasë, ishte bërë një ndarje në perimetrin e 800 metrave brenda mureve ekzistuese²⁶. Vetë Çelebiu nuk e jep datën e ndërhyrjes në kala por, nëse do të kemi parasysh faktin se qyteti u mor prej osmanëve në vitin 1501 dhe se sulltanati i Bajezidit II përfundon në vitin 1512, rrjedhimisht mbështet të dhënat venedikase dhe rrëfimet e Idris Bitlisit.

Menjëherë pas pushtimit qyteti u vendos si qendër kadillëku e varur nga sanxhaku i Elbasanit deri në shek. XIX, kohë në të cilën u lidh me vilajetin e Shkodrës²⁷. Në burimet osmane emri i qytetit përmendet si “*Draç* ose *Dıraç*”. Një burim osman që flet për Durrësin fill pas kalimit nën zotërimin osman është vepra e titulluar *Kitab-ı Bahriye* e gjeografit Piri Reis, i cili duhet ta ketë vizituar bregun e Durrësit rreth dy dekadave të para të shek. XVI. Prej këtij gjeografi kemi një hartë të stilizuar të bregdetit si dhe informacione të pakta mbi vështirësitë e lundrimit dhe kalanë²⁸. Në veprën e tij, Piri Reis thekson se në të dyja anët e gjirit uji

²⁵ *Lufta shqiptaro-turke...*, f. 125, 178-182.

²⁶ E. Çelebi, *Seyahatname...*, f. 711.

²⁷ M. Kiel, “Dıraç...”, f. 522; Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912*, përktheu Klodiana Smajlaj, AIITC, Tiranë: 2002, f. 121. Një listim i ndryshimeve të varësisë administrative të Durrësit përgjatë periudhës së administrimit osman jepet tek Tahir Sezen, *Osmanli Yer Adları*, Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Yayınları, Ankara: 2017, f. 217.

²⁸ Piri Reis, *Kitab-ı Bahriye*, Stamboll: 1526, f. 141-143.

është i cekët dhe se anijet e mëdha që kalojnë nga kjo pjesë duhet të përparojnë me kujdes. Sa për anijet më të vogla, ai thekson se Porto Balo [Kepi i Palit] është një vend më i përshtatshëm për ankorim.

Me shumë interes është një relacion perëndimor i vitit 1570, ku gjejmë përshkrime të qytetit të Durrësit²⁹. Megjithëse të pakta dhe përgjithësuese, janë ndër të dhënat e rralla që paraqesin një pamje të terrenit, qytetit dhe fortifikimeve në këtë periudhë. Ky relacion përmend ndërtimet e realizuara nga osmanët për të përmirësuar fortifikimet. Veçohen dy bastione, njëri në lindje, ndërtuar në vitin 1565, dhe tjetri në perëndim. Fatkeqësisht nuk kemi qartësi në konceptin e autorit mbi “lindjen” dhe “perëndimin”, nëse bëhej fjalë për orientime të sakta gjeografike apo pozicione të përafërta në raport me fortifikimet, të para nga deti.

Dokumentet arkivore tregojnë se përgjatë shek. XVI, megjithëse Durrësi dhe territori ishin përfundimisht nën administrimin osman, ky kontroll nuk ishte i garantuar. Kemi disa raste kur qyteti është sulmuar nga flota venedikase. Këto sulme nuk duket se ishin pjesë e një plani të qartë ripushtimi, por më së shumti pasojë e situatave të momentit. Në vitin 1565-1566, një anije ushtarake venedikase pasi ndoqi një anije pirate, e cila u strehua në portin e Durrësit, nuk ngurroi të bombardonte edhe vetë qytetin³⁰. Sipas këtij dokumenti u rrënuan muret e fortifikimeve si dhe u prish xhamia e qytetit, duke vrarë disa besimtarë brenda saj.

Një tjetër sulm venedikas, shumë më masiv dhe me qëllim të qartë pushtimin e qytetit, ka ndodhur në vitin 1571, kohë e cila përkon edhe me luftën e tretë veneto-osmane³¹. Në këtë dokument jepet një përshkrim i fortifikimeve në pjesën përballë bregdetit (linja juglindore). Plani i sulmit parashikonte të godiste fortifikimet në dy kulla këndore dhe në kurtinën lidhëse mes tyre. Muret e fortifikimeve nuk rezultuan aq të dobët sa ishte vlerësuar dhe nuk u rrëzuan menjëherë nga sulmet. Mësojmë se, nga këto sulme, u dobësuan kullat këndore, të cilat konsideroheshin se ishin të mbushura nga brenda me dhera. Një tjetër e dhënë me interes është

²⁹ Sime Ljubic (bot.), *Starine na sviet izdaje*, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, Knjiga XII, Zagreb: 1880, f. 194-195.

³⁰ Injac Zamputi, *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë (1507-1592)*, vëllimi I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, dok. nr. 215, f. 215.

³¹ Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit*, Tiranë: Toena, 2016, f. 842.

përmendja e një ure në kanalin lidhës të kënetës/lagunës me detin, quajtur “*fiumara*”.

Fillimi i shek. XVII do të kishte një ngjarje të rëndësishme për qytetin, e cila do të bënte jehonë për vite me radhë. Në vitin 1606 një sulm i shpejtë nga një flotë spanjolle e Mbretërisë së Napolit, nën drejtimin e dukës Santa Crocie, arriti të pushtojë qytetin. Pas plaçkitjes, pushtuesit grabitën banorë si skllëvër, i vunë zjarrin dhe u larguan³². Ky pushtim ka lindur shpresat ndër shqiptarët për mundësinë e realizimit të fushatave antiosmane në bashkëpunim me fuqitë perëndimore³³.

Relacionet e tjera, që nga shek. XVII e në vazhdim, japin kryesisht të dhëna të lidhura me banorët e paktë, gjendjen e qytetit si dhe përdorimin e skelës. Përmendja e fortifikimeve ndodh shumë rrallë. Sipas këtyre të dhënave, Durrësi ka pasur një periudhë të gjatë kohore përgjatë së cilës, megjithëse skela ka qenë në përdorim, duke sjellë të ardhura ekonomike, numri i banorëve ishte shumë i vogël³⁴.

Të dhënat që na jep Çelebiu mbartin një rëndësi të veçantë për disa detaje që përshkruan, por nga ana tjetër, ato duhen marrë me kujdes dhe krahasuar me burime të tjera, siç vë në dukje edhe Kiel³⁵. Çelebiu përmend të dhëna të lidhura me aspekte administrative, demografike, kulturore e ekonomike të Durrësit. Në aspektin administrativ, Durrësi varej nga Elbasani, qytet ku ndodheshin edhe selitë e komandantëve të spahinjve dhe atij të jeniçerëve të qytetit. Kadiu i Durrësit, sipas Çelebiut, ndërsa zyrën e kishte në këtë qytet, vetë banonte në qytetin e Kavajës. Siç duket, në Durrës qëndronte vetëm dizdari i kalasë, i cili, sipas Çelebi-ut,

³² *Po aty*, f. 1214, dhe dokumentet e cituara prej tij.

³³ Augustin Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum Medirionalium*, tomus secundus, Zagabriae: 1875, f. 111-112, dok. nr. CXXXIV; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëllimi III (Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak otoman (1506-1839)), përgatitën Aleks Buda, Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1962, f. 127, dok. nr. 71.

³⁴ S. Ljubic (bot.), *Starine na svieta izdaje...*, XX, f. 106; P. Bartl, *Albania Sacra...*, f. 112; E. Çelebi, *Seyahatname...*, f. 711.

³⁵ M. Kiel, *White Tower of Thessaloniki...*, f. 354.

kishte nën varësi rreth njëqind e pesëdhjetë trupa³⁶. Kalaja kishte gjithashtu njëmbëdhjetë topa të vegjël që shërbenin për mbrojtjen e saj³⁷.

Në aspektin ekonomik, Çelebiu e përmend Durrësin si një vend ku prodhohej dhe eksportohej sasi e madhe kripe, e cila tregtohej në brendësi të Ballkanit e më gjerë. Madje, kur nis përshkrimin e kalasë, ai theksonte se kjo ndërtesë ngrihej sipër një “hapësire fushore prej kripe”³⁸. Gjithashtu, edhe porti i këtij qyteti kishte një pozitë të veçantë. Në të ankoroheshin anijet që tregtonin produktet e tregtarëve të mëdhenj të sanxhakut të Elbasanit.

Çelebiu na jep të dhëna mbi aspektin fizik të kalasë së Durrësit në kohën kur ai e vizitoi këtë qytet. Kalaja kishte dy porta, e para shihte nga lindja dhe hapej drejt Elbasanit, ndërsa tjetra hapej nga perëndimi dhe ishte porta që të çonte në skelë. Të gjitha shtëpitë që ndodheshin brenda kalasë ishin të ulëta dhe të mbuluara me tjegulla³⁹. Si fatore ai përmend vetëm xhaminë e Bajezidit, e cila ishte e mbuluar gjithashtu me tjegulla. Për arsye se nëntoka kishte shumë kripë, Çelebiu, shprehej se, këtu nuk kishte bahçe e gjelbërim të madh.

Të dhënat që disponojmë për qytetin e shek. XVII-XVIII janë më të pakta dhe na paraqesin dy pamje të ndryshme. Nga njëra anë kemi vazhdimin e përshkrimit të situatave të vështira dhe rrënimin e qytetit⁴⁰. Një tjetër informacion na dëshmon për një rritje graduale ekonomike, shtimin e numrit të banorëve, hapjen e skelës, zhvillimin e tregtisë, gjë që ka sjellë edhe vendosjen në qytet të konsullatave angleze, franceze, holandeze dhe austriake⁴¹. Këto situata të përmirësuara mund të kenë

³⁶ Në relacionin e vikarit të përgjithshëm të Durrësit, Gherardo Galata në vitin 1669, përmenden afro 100 ushtarë. Shih: P. Bartl, *Albania Sacra...*, f. 166.

³⁷ E. Çelebi, *Seyahatname...*, f. 711.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ P. Bartl, *Albania Sacra...*, f. 166. Relacion i P. Antonio di Spoleto; *po aty*, f. 224. Relacion i Vincenzo Zmaievich; *po aty*, f. 306. Relacion i Niccolo Angeli Radobani, peshkop i Durrësit, 1754-1756; François Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, Edition 2, Tome 1, Paris: Chez Firmin Didot, Père Et Fils, 1826, f. 397.

⁴¹ P. Bartl, *Albania Sacra...*, f. 224-243, 268-271, 288-293, 306; G. Hahn, *Albanesische Studien...*, f. 75; *Instituto Militare Geografico-Firenze*, Foglio 46, II Albania, viti 1818. Me rëndësi janë pesë vjetarët (salname) për vilajetin e Shkodrës të cilat u përkasin viteve 1299 Hixhri (1882-1883), 1310 Hixhri (1892-1893), 1312 Hixhri (1894-1895), 1315 Hixhri (1897-1898) dhe 1316 Hixhri (1898-1899). Këto burime na

pasur zhvillime si në pozitën strategjike ashtu edhe në komponentët e tjerë të jetës, duke përmirësuar imazhin politik, kulturor e demografik. Këto përmirësime të situatës në Durrës duket se kanë sjellë edhe nevojën, apo mundësinë, për të realizuar meremetime të fortifikimeve. Kemi hasur në dy përmendje të meremetimeve të fortifikimeve në këtë shekull, përkatësisht në vitet 1709 dhe 1785⁴².

Gjatë shek. XIX, Perandoria Osmane ndërmori reforma rrënjësore në fushat kryesore të jetës, siç qenë ato administrative, agrare, të drejtat e popullsisë jomyslimane etj. Këto reforma patën një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe në gjendjen politiko-ekonomike të vetë perandorisë⁴³. Padyshim që këto reforma të përgjithshme përfshinë edhe qytetin e Durrësit. Ndryshimi i parë dhe më i dukshëm ishte kalimi i vartësisë së tij administrative nga sanxhaku i Elbasanit nën vilajetin e Shkodrës, duke marrë statusin e qendrës së sanxhakut.

Periudha e Tanzimatit në vetvete shënoi një dobësim domethënës të Perandorisë Osmane si në arenën e diplomacisë së jashtme dhe atë të politikës së brendshme por, më së shumti, në atë ekonomike e ushtarake. Luftërat e shumta në të cilat u përfshi ky shtet e detyruan të merrte hua të shumta nga jashtë, duke iu afruar kolapsit ekonomik⁴⁴. Pikërisht në këtë periudhë, kur vështirësitë ekonomike që haste qendra reflektoheshin edhe në pjesët më periferike të perandorisë, Durrësi njohu një zhvillim të konsiderueshëm si në aspektin politik ashtu edhe demografik, ekonomik e kulturor.

Një tablo të tillë zhvillimi gjithashtu e hasim edhe në aspektin urbanistik të zhvillimit të qytetit por edhe në numrin e faltoreve dhe të shkollave që qyteti kishte në këtë kohë. Në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XIX, Durrësi numëronte tri xhami, një medrese, një ruzhdije, një shkollë katolike, dy ortodokse, dy myslimane dhe katër kisha⁴⁵.

japin një panoramë të detajuar të aspekteve politike, ekonomike, infrastrukturore, demografike e kulturore të të gjitha njësisë administrative që ishin pjesë përbërëse të vilajetit të sipërpërmendur.

⁴² *Arşiv Belgelerine Göre Osmanlı Kaleleri*, T. C. Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü Yayınları, İstanbul: 2016, f. 74.

⁴³ Ali Akyıldız, "Tanzimat", *TDV İslam Ansiklopedisi*, c. XL, İstanbul: 2011, f. 1-10.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ *İşkodra Vilayeti Salnamesi (1310)*, Tab. 3, f. 110.

Megjithatë, krahasuar me Tiranën dhe Kavajën, dy kazatë më të afërta, Durrësi kishte më pak shkollë⁴⁶.

Burimet arkivore na japin mundësinë të përftojmë të dhëna statistikore mbi ndërtesat publike e private të qytetit, të objekteve tregtare dhe ndërtimeve të ndryshme. Janë regjistruar në qytet 9 hane, 1 hamam, 131 dyqane, 112 shitore, 9 furra buke, 2 farmaci, 10 kafene, 3 pijetore, 10 punishte për prodhim tjegullash, 2 depo për mbajtjen e gazit, 35 ahure për ruajtjen e kashtës, 4 çezma dhe 3 puse⁴⁷.

Sezen ka listuar historikun e pozicionit administrativ të Durrësit bazuar tek burimet arkivore osmane, botuar në vitin 2017. Kjo listë tregon për një luhatje të çuditshme të këtij pozicioni të qytetit në shek. XIX. Nga viti 1626 e deri më 1852 ka qenë *nahije* në vilajetin e Rumelisë. Nga 1852 e deri më 1871 ka qenë *kaza* fillimisht nën varësinë e vilajetit të Ohrit e më pas të vilajetit të Shkodrës. Në vitin 1872 është shpallur sanxhak, pjesë e vilajetit të Shkodrës, për t'u rikthyer përsëri kaza në vitin pasues. Pas qëndrimit për dy vjet si nahije (1878-1880) nën vilajetin e Shkodrës, bëhet sanxhak më 1881 dhe i tillë qëndron deri në vitin 1912⁴⁸. Ndryshimi përfundimtar administrativ i vitit 1881 ishte ai që solli një përqendrim më të madh të autoriteteve drejtuese në qytet. Ky moment u shoqërua me ngritjen e ndërtesave të reja dhe me instalimin e institucioneve të ndryshme.

Sipas vjetarëve të vilajetit të Shkodrës, pjesa më e madhe e këtyre ndërtesave ishin ngritur në kohën kur në postin e mytesarifit të Durrësit ndodhej Hafiz Mehmed Pasha⁴⁹, i cili erdhi në këtë detyrë fill pas kalimit të Durrësit në sanxhak duke qeverisur në këtë qytet për një periudhë 6-vjeçare⁵⁰.

⁴⁶ Përkatësisht, në salnamenë e vitit 1882-1883, Tirana me Kavajën kishin nga tri shkolla, ndërsa Durrësi vetëm një të tillë. *İşkodra Vilayeti Salnamesi (1299)*..., f. 7. Kjo diferencë thellohet edhe më shumë për treguesit e tjerë siç është popullsia, ndërtesat private dhe ato publike si dhe objektet tregtare. Në këtë kohë (1892-1893), popullsia e Tiranës së bashku me 101 fshatrat që vareshin prej saj, arrinte shifrën 32.057 banorë. Shih *İşkodra Vilayeti Salnamesi (1310)*..., f. 123.

⁴⁷ *İşkodra Vilayeti Salnamesi (1310)*..., f. 110.

⁴⁸ T. Sezen, *Osmanlı Yer Adları*..., f. 217.

⁴⁹ *İşkodra Vilayeti Salnamesi (1310)*..., f. 109.

⁵⁰ *Haus Hof und Staats Archives, Politisches Archives*, Wien (më tej: *HHSt.A.P.A.A.*), në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 88-46. Sipas një telegrami dërguar

Në kohën e Hafiz Mehmed Pashës në Durrës mësojmë të jenë ndërtuar konaku i qeveritarit⁵¹, burg, konak bastion (tabya konagi), selia e bashkisë, një zyrë telegrafike, një zyrë e taksave, karantinë, zyrë e Dujun-i Umumije⁵², fanar, dajlan, lulishte etj.⁵³. Në punimin e tij mbi monumentet e trashëgimisë osmane në hapësirën evropiane, përveç ndërtesave që përmendëm më lart, Ekrem Ayverdi paraqet gjithashtu si vepra të tjera që gjendeshin brenda kalasë së Durrësit një kullë sahati dhe dy xhami (xhaminë Fatih Sulltan Mehmed Han dhe xhaminë Kaja ‘në burimet turke Kaça’ Hanim)⁵⁴. Ky numër ndryshon nga sasia prej 3 xhamish që shënohen në sallname. Një tjetër dallim vihet re në krahasim me përshkrimet e Çelebiut në lidhje me xhamitë. Ayverdi përmend xhaminë Fatih, siç edhe njihet sot në popull, ndërsa Çelebiu përmend xhaminë e Bajezidit. Sot nuk njihet me këtë emër asnjë nga tre xhamitë që ka pasur qyteti. Besojmë se bëhet fjalë për të njëjtën xhami, por që, ose ka ndryshuar emri ndër shekuj, ose është shënuar gabim nga Çelebiu.

Siç duket nga këto të dhëna, me kalimin e Durrësit nga varësia prej Elbasanit/Ohrit në vilajetin e Shkodrës dhe kthimin në qendër sanxhaku filloi edhe periudha e zhvillimit të shpejtë të qytetit, duke u kthyer sërish në një qendër të rëndësishme, ashtu siç kishte qenë shumë shekuj më herët. Kjo nënkuptohet nga fakti se fill pas vitit 1881, në Durrës do të

nga Durrësi, thuhej se më 23 maj 1887 kishte ardhur vendimi nga Stambolli për shkarkimin e Hafiz Mehmed Pashës.

⁵¹ Për ndërtesën në fjalë përdoren cilësime të ndryshme: në turqisht i referohet si “Hükümet Konağı”; në relacionet perëndimore, kryesisht ato austro-hungareze si “Ndërtesa Qeveritare”; si dhe në zhargonin e gjerë vetëm si “Konaku”. Në këtë punim janë përdorur termat *Ndërtesë Qeveritare* dhe *Konak* për t’iu referuar të njëjtës ndërtesë, selisë së mytesarifit, i cili ishte edhe autoriteti më i lartë përfaqësues osman në qytet.

⁵² Kjo zyrë varet nga selia qendrore që ndodhej në Stamboll. *Dujun-i Umumije* ishte komisioni ndërkombëtar, i cili monitoronte shlyerjen e borxhit të jashtëm osman dhe kishte ekskluzivitetin e taksimit dhe monopolizimit të disa produkteve si alkooli, duhani etj.

⁵³ *İşkodra Vilayeti Salnamesi (1310)...*, f. 109.

⁵⁴ Për monumentet e tjera osmane që E. Ayverdi ka evidentuar si brenda kalasë së Durrësit, ashtu edhe në pjesën jashtë saj, pra në Varosh, shih: Ekrem Hakkı Ayverdi, *Avrupa'da Osmanlı Mimari Eserleri*, c. IV, İstanbul Fetih Cemiyeti, İstanbul: 2000, f. 409.

niste edhe ngritja e institucioneve qeveritare të shoqëruara me ndërtimin e godinave të ndryshme⁵⁵.

Nga ana tjetër, të dhënat mbi kështjellën, për shek. XIX i kemi më të detajuara. Këto burime theksojnë se në gjysmën e parë të shek. XIX, gjendja e kalasë kishte qenë tejet e keqe dhe thuajse e rrënuar tërësisht. Siç duket, kjo ishte edhe arsyeja që në vitin 1835 është përpiluar një defter i hollësishëm ku u evidentuan saktësisht meremetimet që duheshin bërë si dhe ndërhyrjet e tjera që nevojiteshin. Sipas defterit në fjalë, mësojmë se duheshin meremetuar bastionet, frëngjitë, kullat e vrojtimit dhe portat e kalasë⁵⁶. Në vitin 1859 edhe i dërguari austriak, baroni Prokesch kishte shprehur shqetësimin dhe interesimin e tij për një rregullim të kalasë, e cila gjendej në gjendje të mjerueshme.

Në vitin 1863 u hodhën edhe hapat e parë për hartimin e një plani mbi ndërhyrjet që do të bëheshin në kala⁵⁷. Kemi të dhëna për restaurime të kryera në vitet 1863 dhe 1864⁵⁸.

Për planifikimin e ndërhyrjeve të vitit 1863 na informon harta e qytetit e përshkruar më poshtë (**Fig. 3**), përgatitur nga kolagasi Rahmi Beu. Konkretisht, në këtë punim ishte parashikuar restaurimi i katër ndërtesave, të cilat do të përdoreheshin si dogana e qytetit. Sipas të dhënave që kemi, ky plan nuk gjeti miratim. Ndërkohë, nga fotot e fillimshekullit XX dimë se disa nga këto ndërtesa janë ngritur pikërisht në hapësirat e parashikuara. Me shumë mundësi, propozimi në fjalë ka gjetur zbatim pas një periudhe të gjatë kohore.

Në vitin 1864 u hodh në diskutim mendimi për shembjen e kalasë së Durrësit, ndërtimin e disa bastioneve në pika kyçe, ndërsa pjesa tjetër e hapësirës tokësore që mbetej jashtë mureve t'u shitej popullatës për të ndërtuar banesa⁵⁹. Për momentin nuk kemi të dhëna se çfarë ka ndodhur

⁵⁵ *HHSSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 3-2-218. Në një relacion austro-hungarez të dërguar nga Durrësi, më 28 dhjetor 1881, thuhet se nëpunësit e rinj të ardhur për të punuar në institucionet që u ngritën në këtë qendër sanxhaku po hasnin vështirësi të mëdha për të gjetur ambiente banimi me qira pasi shtëpitë ishin thuajse të rrënuara.

⁵⁶ *Arşiv Belgelerine Göre Osmanlı Kaleleri...*, f. 74.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*.

⁵⁹ Studiuesit shprehën se mosaprovimi i planit restaurues të vitit 1863 pengonte zhvillimin urbanistik të qytetit sikurse ndikonte negativisht edhe në vendosjen e tregtarëve, për pasojë, edhe zhvillimin ekonomik të Durrësit. Për më shumë shih *po aty*.

me këtë plan të zhvillimit urban. Ajo që mund të themi, është se ndërkohë që nuk kemi të dhëna mbi prishjen e mureve deri në vitin 1912, disa hapësira që në hartë paraqiten si zona ushtarake, i gjejmë me banesa. Mundet që ky plan të ketë pasur një proces zbatimi të pjesshëm dhe të ngadaltë.

2. Përshkrimi i hartave

Në vazhdim do të analizojmë të tri hartat e përmendura, me të gjitha detajet që nevojiten. Këto harta janë publikuar në një botim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Osmane⁶⁰. Për të ruajtur një rend të njëtrajtshëm në përshkrimet e secilës hartë fillojmë me aspektet e përgjithshme të secilit dokument. Më pas kalojmë në trajtimin e detajeve të fortifikimeve bazuar në rendin gjeografik. Veçojmë linjat e fortifikimeve sipas pozicionit që kanë në kështjellën e qytetit (linjat jugperëndimore, veriore, lindore dhe juglindore) dhe më pas strukturat e tjera jo ushtarake pranë tyre. Detajimi i përshkrimeve tona lidhet ngushtësisht me cilësinë dhe sasinë e paraqitur të informacionit në harta. Në identifikimin e kullave dhe hyrjeve do të përdorim sistemin e emërtimeve të Leon Rey-t.

2.1 Harta e parë (Fig. 1). Viti 1865. Pozicioni në arkivat osmane: i. MVL, 529/23741.

Në një dokument në ngjyrë të verdhë të lehtë, të kornizuar me dy linja të zeza, skicohet planimetria e kështjellës së Durrësit, siç duket ka qenë në funksionim përgjatë periudhës osmane. Qyteti i Durrësit paraqitet si një ishull, dalluar nga ngjyrosja e truallit me ngjyrë bezhë. Brigjet janë konturuar në ngjyrë kafe. Pjesa kodrinore e qytetit është dhënë me breza të valëzuar, me pikëzime kafe. Një urë e lidh qytetin me prapatokën, e vendosur paralel me bregdetin. Në pjesën e sipërme, djathtas, mbi një brez kodrinor, ngrihet një kullë e vogël, me dy dritare dhe e mbuluar me çati. Në pjesën e poshtme të hartës jepet shkalla e zvogëlimit, shumë e detajuar.

⁶⁰ *Po aty.*

Qëllimi kryesor i hartës lidhet me paraqitjen e strukturave ushtarake të kështjellës së Durrësit. Struktura e kështjellës dallohet qartësisht në planimetrinë e saj, me fortifikimin në kodrën 59 m, dhe muret që zbresin poshtë kodrës deri përballë bregdetit. Pothuaj i gjithë fortifikimi rrethohet nga një hendek (**Fig. 1**, nr. 40). Pjesa e perimetrit pranë bregut dhe ballina bregdetare nuk kanë hendek.

Hartografi, në dhënien e përdorimit të strukturave në hartë, ka përdorur dy forma. Njëra është emërtimi i funksionit të ndërtesave të ndryshme në osmanisht përbri secilës ngrehinë. Një tjetër formë është ajo e simbolikës së ngjyrave të përdorura. Me të kuqërremtë jepen muret. Me të kuqe te errët janë skicuar frëngjitë. Strukturat, brendia e të cilave ka qenë në përdorim dhe ishin të mbuluara, janë dhënë me ngjyrim të verdhë. Strukturat, brendia e të cilave nuk ka qenë në përdorim dhe me shumë mundësi të mbushura me dhera, janë mbushur me ngjyrë kafe. Hapësirat që kanë shërbyer si oborre janë lënë me ngjyrën bezhë që përdoret për tokën.

Fortifikimi në kodrën 59 m paraqet formën e mirënjohur pothuaj katërkëndore, me katër kulla në kënde. Vetëm kulla F përshtrohet si në përdorim, identifikuar si “Depo municionesh” (**Fig. 1**, nr. 13).

Në pjesën e poshtme, përballë “Sarajeve të vjetra” (**Fig. 1**, nr. 28), është skicuar një tjetër ndërtesë, me disa kthina, e cila nuk ka një emërtim të përcaktuar. Pozicioni i saj, si edhe planimetria, përkojnë me kishën e Shën Spiridhonit.

Në pjesën e jashtme të kështjellës, në krahun juglindor të saj, skicohet porti me tre skelat e tij dhe ndërtesat e lidhura me shërbimet portuale. Skelat ngjyrosen me të kuqërremtë, si edhe muret, ndërsa brezat me ngjyrë jeshile paraqesin muret kufizuese mes skelave/bregut dhe sheshit të portit. Skela e parë gjendet përballë bastionit Q. Skela e dytë, e cila jepet me një kthesë të lehtë, shtrihet para një porte të vogël që e lidh me sheshin dhe ka kufizime anësore, ngjyrosur me jeshile. Skela e tretë, më e shkurtër në përmasa, lidhet me një hapësirë të kufizuar nga një mur rrethues, brenda së cilës gjenden edhe dy ndërtesa. I gjithë ky kompleks emërtohet si “Karantinë” (**Fig. 1**, nr. 30). Në krahun jugor të këtij kompleksi shtrihet një tjetër, paraqitur si një hapësirë e gjerë, e kufizuar me mur mbyllës dhe me dy ndërtesa brenda. Ajo emërtohet “Teqe” (**Fig. 1**, nr. 31).

Përballë skelës së mesit, paralel me linjën e jashtme të kurtinës Q-Q1, skicohet një ndërtesë e madhe me shumë kthina, e emërtuar

“Dogana” (Fig. 1, nr. 29). Në vazhdim të saj, për nga perëndimi, pason një ndërtesë e dytë, më e vogël, me tre kthina ndarëse, por pa një emërtim specifik.

Nga të tri hartat që shqyrtojmë, kjo hartë ka një seri të dhënash shumë të detajuara të cilat përqendrohen kryesisht në përshkrimin e instalimeve me natyrë ushtarake/mbrojtëse si dhe ato policore. Duke e krahasuar me rilevimet moderne të strukturave të ruajtura të fortifikimeve vërejmë se prirja e përgjithshme e paraqitjes është shumë e drejtë. Mangësia kryesore qëndron në saktësinë e orientimeve të mureve të ndryshme, si në kurtina ashtu edhe tek kullat. Ndërsa të dhënat dhe pozicionimet rezultojnë shumë të sakta, gabimet mund të lidhen me saktësinë e rilevimit, si pasojë e pajisjeve të përdorura.

2.2. *Harta e dytë (Fig. 2). Shek. XIX, ndoshta para mesit të shek. XIX. Pozicioni në arkivat osmane: PLK. P. 836.*

Në një dokument me nuancë ngjyrë vjollcë skicohet një rilevim i qytetit të Durrësit: linja e bregdetit deri përtej Urës së Dajlanit, kështjella, prapatoka e afërt si dhe pjesërisht kodrat. Strukturat e lidhura me kështjellën dhe qytetin brenda saj konturohen me ngjyrë të kuqe. Lagjet brenda kështjellës ngjyrosen me rozë të lehtë. Për hapësirat jashtë mureve janë përdorur të tjera ngjyra, me tonalitete të jeshiles dhe grisë. Bregdeti jepet me tre nivele ngjyrimi blu, nga më e errëta në nuancë më të hapura. Në pjesën e poshtme, majtas, vendoset shkalla e zvogëlimit të hartës.

Hapësira detare, me nr. 22, cilësohet si “Gjiri venecian”. Bregdeti i Gjirit të Durrësit, pranë qytetit, me nr. 10, “Porti”. Në pikëkalimin nga ish kënetë drejt prapatokës është skicuar një “Urë”, me nr. 11. Hapësira e ish kënetës emërtohet “Liqen” (nr. 12). Rruga që kalon mbi urë dhe drejtohet për nga qyteti emërtohet “Rruga për Kavajë” (nr. 13). Ajo vazhdon me disa harkime deri pothuaj përballë portës kryesore të qytetit, drejt së cilës kthehet pothuajse me kënd të gjerë.

E gjithë fusha veriore e qytetit, nëpërmjet së cilës kalon edhe rruga e Kavajës, është e pikturuar me disa hapësira, për të cilat janë përdorur simbolika skicimi dhe ngjyrosjeje të veçanta. Në këtë formë, duke përshkruar me fjalë vetëm njërin nga një grupim i caktuar simbolikash jepet përdorimi për të gjithë grupin. Gjejmë të përdorur termin “Arë” (nr. 31), për hapësira me forma të ndryshme, me një seri linjash të holla, të

zeza, mbushur me ngjyrë jeshile. Me termin “Bahçe”(nr. 30), emërtohen disa hapësira të tjera me forma të ndryshme, ngjyrosur me gri dhe me njolla të zeza brenda. “Moçal” (nr. 32), janë quajtur vetëm dy sipërfaqe, të shtrira mes fushave, oborreve dhe fshatit pranë rrugës së Kavajës. Pranë mureve skicohen disa ndërtesa të vogla, në sasi të kufizuar, emërtuar “Lagja Kopte” (nr. 14).

Mes kësaj lagjeje dhe mureve të kështjellës shtrihet një “Hendek” (nr. 29) dhe një brez me kopshte. Hendeku vazhdon drejt kodrave, duke rrethuar edhe pjesën e sipërme të kështjellës, e cila emërtohet “Kalaja e brendshme” (nr. 23).

Kodifikimi i përdorur për kopshtet rrethon pjesën e jashtme të mureve të kështjellës jo vetëm në krahun lindor por edhe atë verior e perëndimor. Jashtë mureve në krahun juglindor skicohen fusha. Në pjesën veriperëndimore të kështjellës, në zonën kodrinore, emërtohet “Kodra e ullinjve” (nr. 25).

Planimetria e kështjellës nuk dallohet për saktësinë e paraqitjes. Ajo jepet shumë e stilizuar dhe pa detaje. Emërtohen vetëm strukturat kryesore të saj. Pranë kullës G, skicohet një katërkëndësh i madh, emërtuar “Sarajet e vjetra” (nr. 26) në pozicion tërësisht të ndryshëm nga sa e hasëm tek harta e parë.

Vëmë re gjithashtu se në pjesën e brendshme të kurtinave të të gjitha linjave të fortifikimit janë mbështetur banesa. Këto ndalojnë vetëm para murit diagonal që përkufizon oborrin e poshtëm, pranë kështjellës së sipërme.

Në pjesën e brendshme të kështjellës, në zonën e banuar, janë vendosur vetëm katër emërtime. Emërtimi i parë lidhet me emrin e vetë hartës, “Kalaja e Durrësit” (nr. 1). Emërtimi tjetër, vendosur në një nga blloqet e banimit cilësohet si “Çarshia” (nr. 16). Përballë “Portës kryesore”, dallohen dy elementë, një tjetër “Kazermë” (nr. 18) dhe një “Çezmë” (nr. 17).

Në ndryshim nga harta e parë, qëllimi i krijimit të një tjetre lidhet me paraqitjen e një pamjeje përgjithësuese të territorit të qytetit të Durrësit. Kjo duket edhe arsyeja se përse nuk i është kushtuar rëndësi detajeve. Megjithatë, pavarësisht mungesës së detajeve dhe paraqitjes deri diku skematike të saj, kjo hartë ka rëndësi të veçantë pasi paraqet territorin e qytetit brenda mureve si dhe formën e përdorimit të hapësirave jashtë fortifikimit.

2.3. *Harta e tretë (Fig. 3). Viti 1863. Pozicioni në arkivat osmane: i DH 35133.*

Në një dokument të bardhë, me ngjyrimë blu në pjesën e poshtme, për të paraqitur detin, skicohet ballina e fortifikime të qytetit në pjesën juglindore të tyre, përballë Gjirit të Durrësit. Një seri ndërtesash janë dhënë bashkë me legjendat përkatëse, gjithsej 23 të tilla, pranë strukturave të skicuara. Përshkrimet në osmanisht na tregojnë se qëllimi i kësaj harte ka qenë planifikimi i ndërtimeve të reja në bregdetin jashtë mureve, pranë skelave të qytetit. Për këtë arsye ballina e fortifikuar e qytetit nuk jepet e tëra, por pjesërisht. Fillon nga bastioni Q dhe mbyllet tek bastioni S, duke lënë jashtë kullën A dhe kurtinën që e lidhte me bastionin S.

Kurtina lidhëse me bastionin S është identike me kurtinën në pjesën lindore të kullës Q1. Bastioni S është skicuar në mënyrë të paqartë dhe jo në tërësinë e saj. Qartësisht nuk ka qenë qëllimi i skicografisë saktësisht e detajeve. Kemi një paraqitje me katër brinjë dhe një dalje këndore në brinjën e dytë.

Ndërtesat e tjera nuk lidhen direkt me fortifikimet, por me struktura ekzistuese ose të planifikuara për t'u ngritur, pranë portit. Në pjesën e sipërme të dokumentit është skicuar ballina e një ndërtese, mbi të cilën në osmanisht është shkruar "Pamje e ndërtesës që do të ngrihet" (**Fig. 3**, nr. 2). Në krah të saj është dhënë një planimetri funksionale ndërtese, ku është shkruar "Pamje e katit të epërm të hapësirës së doganës" (**Fig. 3**, nr. 3). Brenda këtij plani jepen detaje të tjera të përdorimit të secilës kthinë.

Kjo ndërtesë lidhet me planimetrinë e vendosur jashtë mureve, në këndin e krijuar mes bastionit Q dhe kurtinës (**Fig. 3**, nr. 11), përshkruar në osmanisht si "Plani i ndërtesës". Brenda planimetrisë jepen detaje të përdorimit të kthinave të katit të poshtëm të ndërtesës.

Në krahun perëndimor jepet një tjetër planimetri ndërtese, ku shënohet në osmanisht "Plani i magazinave të vjetra ku do të ndërtohet dogana" (**Fig. 3**, nr. 12).

Poshtë saj, jepet një ndërtesë njëkatëshe, rrethuar me një mur (**Fig. 3**, nr. 14). Përshkrimi në osmanisht është "Medreseja e cila gjendet në afërsi të hapësirës me përmasa 14 zira [krahë]". Ky tekst e lidh funksionin e ndërtesës me një shkollë fetare.

Në lindje të saj është skicuar një ndërtesë e vogël, njëkatëshe. Përshkrimi në osmanisht nuk jep funksionin e ndërtesës. Përballë saj zgjatet një nga tre skelat, e identifikuar si “Skela e karantinës” (**Fig. 3**, nr. 21).

Një gardh i gjatë kufizon të gjithë bregun e detit dhe mbyll komunikimin e skelave me sheshin para fortifikimeve. Nga dy skelat e tjera, ajo e krahut lindor është identifikuar si “Skela e vjetër” (**Fig. 3**, nr. 23). Tjetra identifikohet si “Skela me gjerësi 5 dhe gjatësi 45 zira” (**Fig. 3**, nr. 22).

4. Diskutim mbi fortifikimet e qytetit osman

4.1. Fortifikimet dhe strukturat ushtarake

Duke qenë se trajtimi i fortifikimeve është shumë kompleks dhe i ndërthurur, një grupim i çështjeve bëhet i domosdoshëm. Për këtë arsye kemi grupuar më vete analizën e perimetrit të fortifikimeve, të kështjellës në kuotën 59 m dhe të elementëve ushtarakë në pjesën e brendshme të mureve.

Kështjella e brendshme ose në kuotën 59 m

Njohuritë tona karakterizohen nga mangësi të mëdha në lidhje me përdorimin e këtij territori, përgjatë të gjitha periudhave historike (**Fig. 4**). Njohim vetëm përshkrime të teknikave të ndërtimit të kullave dhe mureve, hamendësime mbi datimet e tyre dhe me përjashtim të përdorimit të kullës F përgjatë periudhës osmane, nuk dimë asgjë më shumë. Edhe më të pakta janë njohuritë mbi territorin brenda mureve. Leon Rey ka realizuar një sondazh të vogël në pjesën më të lartë të territorit, pranë kurtinës F-G (**Fig. 5**), pa gjetje të veçanta⁶¹. Ai dhe Fatos Tartari përmendin praninë e një tuneli ushtarak⁶². Dallohet aktualisht një pjesë qemeri e Antikitetit të Vonë. Përtej këtyre të dhënave nuk njihet

⁶¹ L. Rey, “Fouilles de la Mission Française a Apollonie d’Illyrie et a Durazzo (1823-1924), Sondages a Durazzo”, *Albania - Revue d’Archeologie*, I, Paris: 1925, f. 27, shënimi 61.

⁶² Fatos Tartari, “Elementë të rinj në kalanë e Durrësit të shek. V-VI të erës sonë”, *Monumentet*, nr. 20, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë: 1980, f. 38-40, f. 38-40.

asgjë tjetër. Për rrjedhojë, të gjitha informacionet historike që na japin hartat osmane janë dëshmi me shumë rëndësi (**Fig. 6**). Tek harta e dytë ky territor emërtohet “Kalaja e brendshme” (**Fig. 2**, nr. 23).

Nga kullat këndore të kështjellës, vetëm ajo F del se ka qenë në përdorim, ndërsa kullat G, H dhe I nuk duket se kanë qenë në përdorim në pjesët e brendshme të tyre, përgjatë viteve kur janë realizuar hartat. Ndërkohë që studimi i Gj. Karaiskajt tregon se kullat H dhe I kanë qenë në përdorim përgjatë Mesjetës, duke identifikuar edhe disa faza të përdorimit të tyre. Fakti që në vitet e realizimit të hartave, rezultojnë të papërdorura, dëshmojnë se, në një periudhë të caktuar, ndoshta përgjatë administrimit osman të Durrësit, duhet të jenë mbushur me dhera.

Kulla F sipas L.Rey-t kishte një ambient të përdorshëm vetëm në pjesën e sipërme, me një hyrje mbi kurtinë. Sipas tij, kulla përdorej si depozitë baruti⁶³. Ky përdorim vërtetohet edhe nga hartat osmane (**Fig. 1**, nr. 13; **Fig. 2**, nr. 24), ku përshkruhet “Depo municionesh”.

Kurtina F-G paraqitet e pajisur me pesë frëngji artilerie në pjesën e sipërme (**Fig. 1**). Brendia e kullës G jepet me ngjyrë kafe, që na tregon se nuk ka qenë në përdorim (**Fig. 1**, nr. 7).

Rilevimet e botuara nga L. Heuzey dhe A. Daumet dëshmojnë qartë për një hyrje në kurtinën G-H, e cila nga ana e L. Rey-t nuk paraqitet. Gj. Karaiskaj dhe A. Baçe, përkundrazi shprehen në favor të saj, e emërtojnë G1 dhe e konsiderojnë si të vetmen hyrje në këtë territor. Nga analiza e fotografive të fillimshkullit XX jemi shprehur më parë pozitivisht mbi praninë e kësaj hyrjeje⁶⁴, vërtetuar plotësisht nga hartat osmane. Tek këto harta (**Fig. 1**, nr. 6; **Fig. 2**, nr. 27) shënohet se hyrja emërtohej si “Porta” dhe “Bastioni mbi portë”. Ajo paraqitet me formën e një kulle katërkëndore, me një hyrje në pjesën e jashtme, e cila lidhej me korridor me një hyrje tjetër në pjesën e brendshme.

Kulla H identifikohet thjesht me emrin “Bastion” (**Fig. 1**, nr. 1). Pjesa e brendshme e saj ngjyrosur me kafe, tregon se ka qenë e mbushur me dhera.

⁶³ L. Rey, “Les remparts de Durazzo...”, f. 40.

⁶⁴ Mario Gaglione, Eduard Shehi, “La «Porta del Mare» nella cinta muraria di Durazzo e la chiesa di S. Maria degli amalfitani: ipotesi di identificazione del sito”, në *Rassegna del Centro di Cultura e Storia Amalfitana*, Amalfi: Gennaio-Dicembre 2016, Nuova Serie Anno XXVI, f. 42, fig. 6.1.

Në planin e Laloy-t (**Fig. 4**), botuar nga Heuzey dhe Daumet shënohet prania e një kulle katërkëndore në mes të kurtinës H-I. Rey nuk e ka parë këtë strukturë dhe nuk besonte në ekzistencën e saj⁶⁵. Karaiskaj ka zbuluar gjurmët e një kulle saktësisht në pozicionin e treguar nga planimetria e arkeologëve francezë dhe e ka emërtuar H1⁶⁶. Tek dy nga hartat (**Fig. 1**, nr. 2; **Fig. 2**) kjo kullë është e pranishme, por emërtohet vetëm tek njëra prej tyre, si “Kazerma e topçinjve”.

Kulla I përshkruhet vetëm me emrin “Bastion” (**Fig. 1**, nr. 3). Në pjesën e brendshme është e ngjyrosur me kafe, që tregon se nuk ka qenë në përdorim.

Karaiskaj hedh poshtë mundësinë e ekzistencës së një hyrjeje në kurtinën F-I. Në vitet kur ky studiues ka analizuar fortifikimet e qytetit, kjo kurtinë ka qenë rrafshuar në kuotë të tillë që kishte zbritur nën nivelin e portës. Bazuar tek fotografitë e fillimshekullit XX, Gaglione dhe Shehi përshkruajnë praninë e një porte që lidhte kështjellën e sipërme me pjesën tjetër të qytetit. Dy hartat e para (**Fig. 1**; **Fig. 2**) e vërtetojnë përfundimisht praninë e saj, si një hapje e thjeshtë tek kurtina, pa një emërtim specifik.

Tashmë kemi mundësinë të njohim edhe përdorimin e territorit brenda vetë kështjellës. Ky territor ka si tipar të veçantë relievin shumë të thyer. Nga pjesa më e lartë e saj, pranë kullës G deri në pikën më të ulët, pranë kullës I, ka një disnivel prej mbi 10 m⁶⁷. Për rrjedhojë, është normale që relievi të ketë ndikuar në formën e përdorimit të territorit. Asnjë studiues, i cili është marrë me studimin e fortifikimeve të Durrësit nuk jep të dhëna mbi këtë hapësirë, vetëm duke hamendësuar se këtu gjendej rezidenca e feudalëve arbër dhe më pas e administratorëve venedikas⁶⁸. Në fotografitë e fillimshekullit XX vihen re gjurmë ndërtime, por si pasojë e largësisë nga janë shkrepur fotot nuk kanë asnjë qartësi.

Duke u bazuar tek hartat osmane (**Fig. 1**; **Fig. 2**) ndërtimet brenda kështjellës mund t'i klasifikojmë në mure tarracimi/përforcimi/llogore, rrugë dhe ndërtesa ushtarake (**Fig. 6**). Muret të cilat i kemi identifikuar

⁶⁵ L. Rey, “Les remparts de Durazzo...”, f. 41, shënimi 15.

⁶⁶ Gj. Karaiskaj, “Kalaja e Durrësit...”, f. 33.

⁶⁷ Hartë e relievit të Durrësit, botim ushtarak i vitit 1988.

⁶⁸ *Po aty*, f. 38.

me përdorim tarracimi dhe përforcim i hasim ngjitur me kurtinën H-I, në të gjithë gjatësinë e saj (**Fig. 1**, nr. 4). Nga ana e topografit osman janë emërtuar si “Bastion”. Duke pasur parasysh faktin se gjendej në pjesën e brendshme të mureve dhe nuk duket të ketë asnjë rol mbrojtës, besojmë më shumë në ndërtimin e saj për qëllim përforcimi të kurtinës H-I. Në mënyrë të ngjashme me të, një tjetër strukturë është ndërtuar në pothuaj të gjithë gjatësinë e brendshme të kurtinës F-G (**Fig. 1**, nr. 9), emërtuar përsëri si “Bastion”. Në këtë rast duket se gjatësia e saj ka kapur vetëm pjesën më të thyer të relievit. Një tjetër strukturë është emërtuar si “Llogore” (pozicion) (**Fig. 1**, nr. 5). Ajo shtrihej nga pjesa qendrore e territorit dhe zgjatohej drejt kullës G.

Të vetmet ndërtesa të shënuara në harta, të cilat nuk janë pjesë e fortifikimeve lidhen me përdorime ushtarake. Dy prej tyre i mbështeten kurtinës F-I. Nga topografi osman ato janë përshkruar si “Hambari i topçinjve”, “[Vendqëndrim për] Zabitë” dhe “Kazerma e topçinjve” (**Fig. 1**, nr. 11, 12; **Fig. 2**, nr. 28).

Perimetri i fortifikimeve

Përgjatë periudhës osmane perimetri i fortifikimeve qarkohej nga një hendek pothuaj në të gjithë gjatësinë e tij, përmendur nga L. Heuzey dhe A. Daumet⁶⁹, të cilët e kanë parë, si edhe nga A. Schober⁷⁰, disa dhjetëvjeçarë më pas, por vetëm në linjën jugperëndimore. Prania e hendekut shënohet qartësisht tek dy harta osmane (**Fig. 1**, nr. 40; **Fig. 2**, nr. 29). Ai fillonte pranë kullës A në linjën jugperëndimore, shkonte paralel me muret duke iu ngjitur kodrës, qarkonte kështjellën e sipërme dhe zbriste poshtë kodrës duke ndjekur linjën veriore të mureve. Hendeku ndërpritej për të krijuar një shteg kalimi përballë Portës së Madhe. Hartat në trajtim tregojnë se hendeku është ruajtur funksional deri në vitin 1861, kur e kanë parë studiuesit francezë. Gjurmët e tij kanë mbijetuar deri në vitet e Luftës së Parë Botërore, parë nga A. Schober⁷¹.

⁶⁹ L. Heuzey, H. Daumet, *Mission archéologique...*, f. 355.

⁷⁰ C. Praschniker, A. Schober, *Archäologische Forschungen...*, f. 34.

⁷¹ *Po aty*.

Linja jugperëndimore

Skicimi i kësaj linje nuk dallon shumë nga rilevimet moderne. Ndryshimet janë të lidhura kryesisht me saktësinë e pajisjeve të përdorura nga topografi osman. Nga hartat mund të nxjerrim disa detaje me interes, kryesisht të lidhura me përdorimin e fortifikimeve në periudhën osmane.

Kulla A ka formë rrethore, e pajisur me 5 frëngji artilerie (**Fig. 1**, nr. 37). Në periudhën moderne pjesa e sipërme e kësaj kulle është restauruar duke e ndryshuar karakterin e frëngjive masive të artilerisë, transformuar në gjoksore. Hyrja për në kullë hapet në këndin e krijuar nga bashkimi i kurtinave A-B dhe A-S me vetë kullën, ngjashmërisht siç e shikojmë edhe sot. Pjesa e brendshme e saj paraqitet me mbushje ngjyrë kafe. Kjo ngjyrosje është përdorur për kullat që nuk kanë hapësira të brendshme apo nuk janë përdorur. Ndërkohë ne njohim gjerësisht praninë e një ambienti qendror ku vendosej artileria dhe disa kthinave të vogla, ndihmëse. Ndoshta, duhet të mendojmë se në kohën e realizimit të rilevimit osman hapësira e brendshme mund të ketë qenë e mbushur me dhera.

Kjo kullë identifikohet në harta qartësisht me emrin “Bastioni venecian” ashtu sikurse në toponiminë popullore si “Torra veneciane”. Tashmë ne kemi dorëzuar për botim një artikull ku merret në trajtim historia e kësaj kulle dhe mbështesim idenë e ndërtimit pas pushtimit osman të Durrësit⁷². Përdorimi i emrit “Bastioni venecian” në shek. XIX nuk përbën një provë të kronologjisë së saj. Ajo duhet konsideruar si një zhvendosje e emrit nga një kullë më e hershme që dikur lartësohej aty pranë⁷³, tek ndërtimi më i ri, kulla A. Më tej, përgjatë këtij artikulli sikurse në rastin e “Portës së Detit” do të shikojmë se nuk është ky i vetmi rast i zhvendosjes së emrit nga një strukturë më e hershme drejt një strukture më të re, ndërtuar në afërsi. Në rastin e kullës A, paraardhësja e saj ka qenë një kullë të cilën ne e kemi quajtur A1⁷⁴.

⁷² Eduard Shehi [në proces botimi], “Evoluimi i linjës juglindore të fortifikimeve të Durrësit dhe datimi i “Torra veneciane”, *Monumentet*.

⁷³ C. Abadie-Reynal, A. Lefebvre, E. Shehi, B. Shkodra-Rrugia, “Topografia e Epidamne-Dyrrachion...”, f. 193-199.

⁷⁴ E. Shehi, “Evoluimi i linjës juglindore.....”.

Kulla A1 është identifikuar prej nesh saktësisht në pjesën e hartës nr. 1, ku vihet re një rritje e trashësisë së kurtinës dhe më pas hollimi i menjëhershëm i saj, pranë kullës A në drejtim të kullës B. Në hartën e parë (**Fig. 1**) vihet re një skicim i një konturi të hollë të vizatuar nga topografi osman, i ngjashëm me profilin e kullave B-E, por me përmasa shumë më të vogla. Në pak foto të fillimshkullit XX ku paraqitet edhe pjesa e mureve pas kullës A, me vështirësi, dallohen gjurmë të pakta të mbijetuara në lartësi të ulët të një strukture që del nga kurtina. Mundet që të kemi të bëjmë me mbetjet e fundit mbi nivelin e ecjes së kullës A1.

Kullat B-E janë paraqitur me formën pesëkëndore, të cilat bashkë me kurtinat përkatëse janë ndërtime tipike të Antikitetit të Vonë të cilat mendohet se datojnë në kohën e sundimit të perandorit bizantin Anastas⁷⁵. Pavarësisht mungesës së saktësisë së paraqitjes së tyre në hartat osmane, planimetria duket e qartë. Secila prej këtyre kullave paraqet disa veçanti në raport me njëra-tjetrën.

Kulla B, e emërtuar si “Bastioni i Ibrahimit” (**Fig. 1**, nr. 38) ka si tipar skicimin e shtatë frëngjive për pushkë në pjesën e sipërme të saj. Në realitetin e sotëm ne njohim praninë saktësisht të shtatë frëngjive në katin e dytë të kullës së periudhës antike të vonë⁷⁶. Ngjyrosja me kafe tregon se në shek. XIX, në mos edhe më parë, katet e poshtme të kullës antike të vonë nuk ka qenë në përdorim.

Kulla C emërtohet “Bastioni i Muradit” (**Fig. 1**, nr. 39) dhe paraqitet më e vogël në përmasa se kullat e tjera. Brenda saj janë skicuar shtatë frëngji pushke. Në këndin lindor, aty ku bashkohet me kurtinën, është skicuar një kënd muri që del nga linja. Dimë tashmë se kulla C ka pësuar një shkatërrim të faqes perëndimore përgjatë Mesjetës dhe është rindërtuar, por me përmasa më të vogla⁷⁷. Gjendja e dobët e ruajtjes së saj nuk ka lejuar saktësimin e një seri detajesh, për rrjedhojë nuk ka qenë e

⁷⁵ Eduard Shehi, “Review of the ancient and late antique fortifications of Epidamons-Dyrrachion”, në L.M.Caliò, G.M.Gerogiannis, M.Kopsacheili, *Fortificazioni e società nel Mediterraneo occidentale- Fortifications and Societies in the Western Mediterranean. Albania e Grecia settentrionale. Atti del Convegno di Archeologia, organizzato dall’Università di Catania, dal Politecnico di Bari e dalla University of Manchester, Catania-Siracusa 14-16 febbraio 2019*, Catania: Università di Catania, 2020, f. 63-76.

⁷⁶ Gj. Karaiskaj, A. Baçe, “Kalaja e Durrësit...”, f. 10-11.

⁷⁷ Po aty, f. 10-11.

mundur të shikohet nëse ka pasur apo jo shtatë frëngji në pjesën e sipërme. Ende sot, në pjesën ku faqja lindore bashkohet me kurtinën, ka një strukturë muri e cila del vertikalisht me disa dhjetëra centimetra. Ngjyrosja me kafe tregon se hapësira e brendshme nuk ka qenë në përdorim.

Kulla D, emërtuar “Bastioni i fikut” (**Fig. 1**, nr. 41) paraqet në pjesën e sipërme tre frëngji për artileri, ndërsa në pjesën e pasme ka dy linja muresh, që duket sikur konturojnë korridorin e një hyrjeje e cila mund të korrespondojë me hyrjen e sotme për në amfiteatër ose paraqet një shkallë për hipjen në nivelet e sipërme të murit fortifikues. Me rëndësi është edhe fakti se Karaiskaj dhe Baçe kanë gjetur gjithashtu gjurmë të hyrjes së katit të parë të kullës, hapur në murin e pasmë⁷⁸, gjë që korrespondon me skicimin e hartave osmane. Muret që krijojnë korridor para hyrjes nuk janë vënë re prej tyre. Fakti që ndryshe nga dy kullat e tjera të parapërmendura këtu skicohen vetëm frëngji artilerie, na shtyn të mendojmë se realisht duhet të ketë pasur një nivel të sipërm ku ka qenë vendosur artileri. Pjesa e brendshme e saj ka qenë e mbushur me dhera, siç duket edhe nga një foto që ruhet në Muzeun Marubi dhe është gërmuar nga Vangjel Toçi në vitet 70-të të shekullit të kaluar ashtu sikurse është indikuar edhe në hartën osmane (Fig. 1, nr. 41).

Kulla E emërtohet “Bastioni i Seferedinit” (**Fig. 1**, nr. 42). Në pjesën e sipërme janë skicuar katër frëngji artilerie. Muri i pasmë skicohet shumë më i hollë sesa trashësia e kurtinës, ndërkohë që jepet me trashësi të njëtrajtshme tek kullat B-D. Kurtina nga krahu perëndimor i saj paraqet një shmangie nga linja pothuaj e drejtë e pjesës tjetër të mureve. Në pjesën e brendshme të kullës, krahu perëndimor, ngjitet muri i brendshëm që ndan oborrin e parë të kështjellës nga pjesa tjetër e qytetit. Aktualisht nga kjo kullë ruhen vetëm gjurmët e dy faqeve që lidheshin me kurtinat dhe pjesë të qemerit të murit të brendshëm. Kjo kullë ruhej gjysmë e rrënuar deri në fillimin e shek. XX, ku shikohej në këmbë gjysma perëndimore e saj dhe qemeri i faqes së brendshme qëndronte i plotë. Brendia e kullës është e ngjyrossur me kafe, që tregon mospërdorimin e saj.

⁷⁸ Po aty, f. 11.

Linja veriore

Kjo linjë e fortifikimeve është datuar si ndërtim i periudhës osmane⁷⁹. Ajo fillon nga kurtina prapa kullës I dhe vazhdon deri në pikëtakimin me linjën lindore. Fortifikimi paraqitet me një linjë të drejtë, të njëtrajtshme, të shkëputur vetëm nga hyrja e fortifikuar K.

Kulla J emërtohet “Bastioni i flamurit” (**Fig. 1**, nr. 18). Ka formë drejtkëndore, nga brenda është e ngjyrosur me kafe duke na treguar se nuk ka qenë në përdorim. Nga rilevimet e kryera në këtë kullë është provuar se ka planimetri drejtkëndore (5.15x4.50 m) dhe 3 kate. Ndërsa kati i parë është gjetur i mbushur me dhera, kati i dytë duket se ka qenë në përdorim në vitet kur Karaiskaj e ka rilevuar. Kati i tretë ishte i hapur. Mbetet e paqartë arsyeja e këtij dallimi. Besojmë se me braktisjen e fortifikimeve si të tilla dhe me largimin e garnizonit osman më 1912, kjo strukturë, si dhe të tjerat, duhet të jenë braktisur. Më pas, fati i tyre mbetet i paqartë, ndoshta janë ripërdorur si banesa, duke u realizuar ndërhyrje të ndryshme. Emërtimi që i është shënuar tek harta e parë tregon qartësisht funksionin e saj pas ndërtimit nga ana e osmanëve.

Hyrja e fortifikuar K emërtohet si “Porta e varoshit” (**Fig. 1**, nr. 20) ose “Porta e madhe” (**Fig. 2**, nr. 19). Nga skica paraqitet si një korridor i gjatë, i mbuluar, me dy porta në ekstreme. Pjesa ballore e saj paraprihet nga një rrugë e kufizuar nga të dyja krahët prej ledheve. Heuzey nuk e përshkruan me detaje këtë hyrje. Të dhënat që na jep janë shumë të përmbledhura. E emërton “Porta e Madhe”, porta kryesore nga ana e tokës, hapur në mes të një kulle të madhe katrore ndërtuar me aq shumë elementë arkitektonikë të ripërdorur sa cilësohet si një muze⁸⁰. Rey e quan “kullë antike”⁸¹, pa dhënë qartësi për një emërtim të tillë. Porta duket të jetë dëmtuar rëndë në tërmetin që përfshiu qytetin e Durrësit në vitin 1926⁸², pas vitit 1945 ajo nuk ishte më e dukshme në sipërfaqe.

⁷⁹ Po aty, f. 36, 40.

⁸⁰ L. Heuzey, H. Daumet, *Mission archéologique...*, f. 359.

⁸¹ L. Rey, “Les remparts de Durazzo...”, f. 43.

⁸² Lumo Skendo, “Tërmeti”, *Diturija*, nr. 4, Selanik: Shtypshkronja Mbrothësia, 1927, f. 132.

Ngjitur me të, në pjesën e brendshme, ekziston një strukturë gjatësore, e mbuluar, emërtuar “Karakoll” (**Fig. 1**, nr. 21). Një tjetër strukturë, me të njëjtin emërtim, gjendet pranë saj, nga krahu lindor (**Fig. 1**, nr. 22).

Kulla L në hartën e parë emërtohet thjesht “Sahati” (**Fig. 1**, nr. 23) ndërsa në hartën e dytë emërtohet si “Kulla e Sahatit” (**Fig. 2**, nr. 15). Aktualisht kjo kullë ruhet pjesërisht vetëm në faqen veriore dhe perëndimore. Lartësia maksimale e ruajtur është 4.40 m. Një gjurmë frëngjie ruhet në faqen perëndimore⁸³. Struktura është e ndërtuar me shumë elementë arkitektonikë të ripërdorur. Në fotografitë e fillimshkullit XX vihet re se mbi kullë lartësohet një strukturë katërkëndore, mbi të cilën qëndronte një kambanare. Mes banorëve të qytetit kjo strukturë njihet ende sot si “Kulla e Sahatit”. Ngjyrosja me të verdhë tregon se brendia e saj ka qenë në përdorim.

Linja lindore

Kjo linjë fillon në pikëtakimin e vijës veriore, ku ka një kthesë me kënd të gjerë dhe ku vendoset kulla M. Kurtina zgjatet paralel me bregdetin dhe është e pajisur me tri kulla, përfshirë atë M. Mund të bëjmë një ndarje në dy pjesë të kurtinës, si pasojë e paraqitjes së disa kthesave të lehta përgjatë linjës së saj. Gjysma e parë, ajo veriore, ka linjë pothuaj të drejtë. Gjysma e dytë e kurtinës paraqet pesë kthesa para se të bashkohet me bastionin Q. Kthesat e kurtinës në hartën e parë (**Fig. 1**) kanë ngjashmëri të pjesshme me hartën e Laloy-t (**Fig. 4**) ndërsa krahasuar me rilevimin e realizuar nga Rey (**Fig. 5**) paraqesin ndryshime. Duhet gjithashtu të nënvizojmë faktin se Rey e ka gjetur pothuaj tërësisht të rrënuar këtë linjë dhe nuk mund të shprehemi me siguri mbi saktësinë e rilevimit të tij.

Numri i kurtinave që gjejmë në hartën osmane nuk korrespondon me kullat e paraqitura nga Heuzey (**Fig. 4**) e më pas L. Rey (**Fig. 5**). Harta osmane paraqet tri kulla, hartat e arkeologëve francezë paraqesin katër të tilla. L. Rey përmend kullën M, e cila mungon në hartën e tij (por gjendet në hartën e Laloy-t), dhe paraqet të skicuara tri kulla të tjera,

⁸³ Gj. Karaiskaj, "Kalaja e Durrësit...", f. 38.

emërtuar N, O, P. Bastioni Q dhe kulla M janë dy pika të njëjta për hartën osmane dhe atë të Heuzey-t. Më tej, kulla N duket gjithashtu se është identike në vendosje. Gabimi mes hartave qëndron tek kullat O, P dhe kthesat e kurtinës. Pranë *bastionit* Q ka një shkallëzim të kurtinës, e cila del nga jashtë murit si një bastion i vogël. Ky detaj vihet re tek të dyja hartat osmane të fortifikimeve (**Fig. 1; Fig. 2**), çka vërteton ekzistencën e strukturës në fjalë. Më tej, në pjesën veriore të këtij “bastioni” në të dyja hartat vendoset një kullë, e cila do të korrespondonte me atë që emërtohet nga L. Rey me germën P (**Fig. 5**). Për rrjedhojë, pasaktësia mes hartave ngushtohet tek kulla O. Pozicioni i saj tek hartat osmane (**Fig. 1; Fig. 2**) përkon me disa kthesa të kurtinës. Pikërisht këto kthesa duhet të kenë krijuar vështirësi interpretimi tek topografi osman ose tek ai francez. Topografi osman ka treguar saktësi detajesh të tilla që nuk mund të besojmë se ka harruar pa vendosur një kullë të tërë. Nga ana tjetër, L. Heuzey, A. Daumet dhe L. Laloy i kanë parë muret në këmbë 4 vjet para se harta osmane të realizohej. Përshkrimet e realizuara prej tyre gjithashtu na kanë rezultuar të sakta në shumicën e rasteve. Shpresojmë se do të krijohen mundësitë që në të ardhmen të realizohen gërmime arkeologjike për të saktësuar një detaj kaq të rëndësishëm për këtë pjesë të fortifikimit. Ne, në vazhdim, po përshkruajmë kullat M, N dhe P, të cilat i gjejmë tek të dyja hartat e fortifikimeve (**Fig. 1; Fig. 2**). Kullën O po e lemë jashtë vëmendjes për momentin, përse kohë ka dyshime në ekzistencën e saj.

Kulla M emërtohet thjesht “Karakoll” (**Fig. 1**, nr. 24). Heuzey nuk jep përshkrime të saj ndërsa Rey ka gjetur gjurmët e themeleve dhe, mesa kuptohet, murin e brendshëm të kullës⁸⁴. Megjithatë, ai nuk e ka vendosur në hartën e fortifikimeve që ka botuar, por është mjaftuar me përmendjen e saj nën germën M. Tek harta e parë është e ngjyrosur me të verdhë, që tregon se ka qenë në përdorim.

Kulla N nuk emërtohet fare në hartën e parë (**Fig. 1**). Paraqitet në planimetri si një drejtkëndësh i vogël, me përmasa më të kufizuara nga kullat e tjera. Nuk gjejmë përshkrime nga ana e Heuzey-t por, është parë nga Rey, i cili vetëm sa e përmend⁸⁵. Aktualisht ruhet pjesërisht nën ndërtesat moderne, ndërtuar me shumë materiale të ripërdorura.

⁸⁴ L. Rey, "Les remparts de Durazzo...", f. 44-45.

⁸⁵ Po aty, f. 44.

Kulla P emërtohet si “Depo municionesh” (**Fig. 1**, nr. 25). Nuk e gjejmë të përshkruar në asnjë nga botimet e rëndësishme mbi fortifikimet e Durrësit. Për Rey-n kjo kullë korrespondon me atë që ai e ka emërtuar me germën P⁸⁶, pasuar më pas edhe nga Karaiskaj⁸⁷. Të dy e kanë gjetur të shkatërruar. Duke qenë në përdorim si depo, brendia e saj është ngjyrosur me të verdhë.

Linja juglindore

Kjo linjë e fortifikimeve fillon nga bastioni Q, e cila e bashkon me linjën lindore dhe vazhdon deri tek kulla A, ku realizohet bashkimi me linjën jugperëndimore. Kjo linjë paraqet disa detaje me shumë rëndësi për të njohur evolucionin e strukturave përgjatë shekujve.

Bastioni Q. Kjo strukturë, herë identifikuar si kullë e herë si bastion, emërtohet me germën Q nga ana e L. Rey-t⁸⁸. Tek harta e parë emërtohet si “Bastioni i eminit” (**Fig. 1**, nr. 26). Tek harta e dytë emërtohet “Bastioni kryesor” (**Fig. 2**, nr. 8). Tek harta e tretë, megjithëse me pamje ballore dhe të detajuar, legjenda vendoset sipër një ngrahine mbi këndin perëndimor dhe emërtohet “Hapësirë e pjesëve përbërëse të kalasë” (**Fig. 3**, nr. 10).

Ky bastion ngrihej në ekstremin juglindor të fortifikimeve dhe bashkonte linjën lindore me atë juglindore. Ka pasur një planimetri në formë shumëkëndëshi, e përbërë nga disa elementë, rezultat i ndërhyrjeve ndërtimore në periudha të ndryshme kohore. Ekstremi lindor paraqitet si një strukturë e shkëputur nga pjesa tjetër e bastionit. Paraqet një profil të ngjashëm me kullën A por me planimetri drejtkëndore. Ka një bazë trungkonike, e cila ngrihet mbi një hapësirë të pikëzuar – ndoshta shkëmbinj, e cila fillon nga toka dhe shkon brenda në det. Këtu vërejmë një dallim mes hartës dhe fotografive të ruajtura. Tek harta 3 (**Fig. 3**) baza trungkonike paraqitet shumë e lartë dhe në pjesën e sipërme ka një brez horizontal, që del në gjerësi nga profili i mureve. Tek fotografitë e të njëjtës strukturë baza trungkonike shfaqet shumë më e ulët dhe lidhet me faqen vertikale të murit pa asnjë element shtesë. Një kornizë horizontale,

⁸⁶ Po aty, fig. 2.

⁸⁷ Gj. Karaiskaj, “Kalaja e Durrësit...”, f. 39-40.

⁸⁸ L. Rey, “Les remparts de Durazzo...”, f. 45.

e rrumbullakosur, ndan këtë faqe muri me nivelin e frëngjive. Tek harta 3 paraqiten tre frëngji artilerie të mbuluara me qemer. Në pjesën e sipërme ka një muraturë ku mungojnë truporet. Në krahun e majtë vazhdon kurtina e fortifikimit. Në mesin e lartësisë së saj dallohet një brez horizontal në të gjithë gjatësinë dhe mbi të janë skicuar katër frëngji të mbuluara me qemer. Pjesa e sipërme e murit duket se është skicuar në mënyrë të ngjashme me kullën, me mur pa trupore.

Ngjitur me të vazhdon kurtina drejt perëndimit. Në pamje ballore (**Fig. 3**) ka katër frëngji artilerie. Në këndin lindor është skicuar një ndërtesë, ngritur mbi mure, me tre dritare dhe e mbuluar me çati.

Në plan, pesë prej brinjëve të bastionit kanë shenja frëngjish për artileri (**Fig. 1**). Ekstremit lindor i bastionit shfaqet si një “kullë” katërkëndore, shtojcë në strukturën kryesore. Hyrja për në bastion gjendej në pjesën e brendshme, pranë perimetrit lindor të fortifikimit. Në pjesën e brendshme ka pesë kthina, të ngjyrosura me të verdhë, duke na treguar se ishin në përdorim. Hapësira pranë frëngjive dhe “kulla” katërkëndore në ekstremin lindor janë mbushur me ngjyrë kafe, duke na treguar se në momentin e skicimit ishin të mbushura dhe të papërdorshme. Pjesa tjetër ka ngjyrën e territorit ku shtrihet kështjella, që na bën të besojmë se ishte sipërfaqe e hapur, në formën e një oborri.

Deri në vitin 1918 ruhej e gjitha në këmbë, siç dëshmojnë edhe imazhet fotografike të kohës. Ka pësuar dëme të konsiderueshme përgjatë Luftës së Parë Botërore, veçanërisht ekstremit lindor i saj (elementi që e kemi quajtur “kullë”). Në vitin 1925 u rrafshua për t’i lënë vend ndërtimit të degës së Bankës së Shqipërisë.

Ky bastion paraqitet në planimetrinë e Heuzey-t dhe Daumet-it (**Fig. 4**), si dhe në atë të Rey-t (**Fig. 5**). Në asnjë rast nuk ka pasur një përshkrim të detajuar të saj, me gjithë rëndësinë që Heuzey i ka dhënë. Për këto arsye, jemi detyruar që në një artikull të kohëve të fundit të bëjmë një përshkrim të saj bazuar tek imazhet fotografike si dhe të tentojmë një analizë kronologjike⁸⁹.

Kulla Q1. Bëhet fjalë për një kullë gjysmërrethore, e mbijetuar deri në ditët tona, shumë e dëmtuar, të cilën e kemi quajtur më parë me emrin Q1⁹⁰. Në këndet lidhëse me kurtinat ruhet nga një shkallëzim i vogël. Kjo

⁸⁹ E. Shehi, “Evoluimi i linjës juglindore ...”.

⁹⁰ Po aty.

strukturë emërtohet si “Sarajet e vjetra” (**Fig. 1**, nr. 28). Ky emërtim lidhet me praninë e pesë kthinave në pjesën e pasme të saj, të ngjyrosura me të verdhë. Drejt krahut lindor ka një mur kufizues të një hapësire që duket si oborr i brendshëm. Tek harta e tretë jepet me pamje ballore dhe në nivelin e gjoksoreve ka dy dritare. E gjithë struktura është e mbuluar me çati konike, që tregon se ishte në përdorim (**Fig. 3**). Përshkrimin e detajuar të mureve ekzistuese e kemi realizuar më herët⁹¹.

Hyrja e fortifikuar “Porta e Detit” -R, R1 dhe R2. Një nga portat kryesore të qytetit osman ruhej në linjën juglindore të fortifikimeve dhe njihej me emrin Porta e Detit⁹² ose porta R sipas Rey-t (**Fig. 5**). Pamjet fotografike të fillimshekullit XX na tregojnë hollësitë e kullës falë të cilave mund të kuptojmë organizimin planimetrik. Bëhej fjalë për një hyrje me korridor të gjatë, me dy porta në ekstreme me drejtim lëvizjeje pingul me linjën e murit fortifikues. Mbi korridor ngrihej një kat i dytë. Forma planimetrike e ngrehinës ishte drejtkëndore. Pjesa ballore e saj nuk zhvillohej jashtë kurtinës së murit, por zgjatohej përtej pjesës së brendshme të saj. Në faqen e brendshme (perëndimore) kishte një hyrje të vogël në krah të portës së qytetit. Ajo shërbente për t’u ngjitur në katin e sipërm të kullës. Këtu gjendej një hapësirë e ndriçuar me nga dy dritare të hapura drejt lindjes dhe perëndimit. E gjithë struktura mbulohej me çati.

Në dokumentet mesjetare që kemi arritur të shfletojmë gjejmë përmendjen e një porte me të njëjtin emër dhe në një hapësirë të përafërt me të sipërpërmendurën së paku tri herë. Në dy raste bëhet fjalë për akte noteriale shitjeje, ku jepet përshkrimi i vendosjes së pronës së shitur, në afërsi të kësaj porte, por pa caktuar detaje mbi pozicionin e saj. Më i vjetri ndër këto dokumente i takon vitit 1338⁹³ dhe përmendet dekarkia e

⁹¹ E. Shehi, “Contributo sulla topografia di Dyrrachium ...”, f. 164.

⁹² Afrim Hoti, Elvana Metalla, Eduard Shehi, “Gërmime arkeologjike Durrës 2001-2003”, *Candavia*, 1, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 2004, f. 140, fig. 1; E. Shehi, “Contributo sulla topografia di Dyrrachium ...”, f. 164.

⁹³ Ky akt gjendet në numrin *Codice Cicogna 2835*, ruajtur në Museo Correr di Venezia, botuar nga Gastone Breccia, Antonio Rigo, Una carta privata greca da Durazzo (giugno 1338), në *Albania. Immagini e documenti dalla Biblioteca Nazionale Marciana e dalle collezioni del Museo Correr di Venezia*, Istituto Italiano di Cultura, Tirana: 1998, f. 68-74.

“*Θαλασίας Πόρτας*” (Porta e Detit). Në një dokument të vitit 1427⁹⁴ për shitjen e një terreni me pemë frutore përcaktohej se gjendej “*in paragio porte maris*”⁹⁵. Dokumenti i tretë i takon vitit 1460⁹⁶ ku jepen urdhëresa mbi kalimin e ngarkesave të kripës në qytet, duke na dëshmuar se *porta Maris* shërbente si pikë doganore.

Përmendjen e parë në periudhën osmane e hasim në përshkrimet e Evlia Çelebi-ut, që ka vizituar qytetin në vitin 1670. E. Çelebi e quante “*emin-i iskele*”⁹⁷, përkthyer në shqip “Porta e Skelës”⁹⁸. Në versionin anglisht e hasim si “*Dock’s Agent gate*”⁹⁹. “*Seethore*” e quan në vitin 1854 G. von Hahn¹⁰⁰. L. Heuzey dhe A. Daumet, të cilët e kanë vizituar qytetin në vitin 1861 dhe botuar në vitin 1876, e quajnë “*Porta Yali*” ose “*Porte de Mer*”¹⁰¹. Në vitin 1893 përshkruhet si në vijim: “*une seule porte, la Porte du quai, -Porta Yali-, mène dans la ville, à travers la douane et la police*”¹⁰².

Në gërmimet arkeologjike të vitit 2017 patëm mundësinë të gërmojmë një sondazh në pjesën lindore të vendndodhjes së kësaj porte sipas të dhënave të shek. XX¹⁰³. Tashmë kemi përshkruar në mënyrë të detajuar, duke datuar periudhat ndërtimore¹⁰⁴. Rrafshimi i strukturave në

⁹⁴ Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, vol. XVII, Rodulpho Trofeniko editore, Typographia Pont. Universitatis Gregorianae, Rome: MXMLXXIII, 3127 qu, viti 1427.

⁹⁵ Pranë Portës së Detit. Për një analizë më të detajuar të dokumentit shih Mario Gaglione, Eduard Shehi, *Un documento angioinodel 1280 per il castrum Durachi*, ASPN CXXXVII, 2019, f. 353-370.

⁹⁶ Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, vol. XVII, Rodulpho Trofeniko editore, Panormi in Scuola Graphica Salesiana, Rome: MXMLXXVII, nr. 6979, viti 1460.

⁹⁷ Robert Dankoff, Robert Elsie, *Evliya Çelebi. Seyahatnameh, Book of Travels. Vol. II, Evliya çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*, Leiden: Brill, 2000, f. 51.

⁹⁸ *Shqipëria: para tre shekujsh*, përkthyer nga Sali Vuçiterni, Tiranë: Besa, 2000, f. 81.

⁹⁹ R. Dankoff, R. Elsie, *Evliya Çelebi...*, f. 51.

¹⁰⁰ G. Hahn, *Albanesische Studien...*, f. 75.

¹⁰¹ L. Heuzey, H. Daumet, *Mission archéologique...*, f. 355.

¹⁰² Victor Bérard, *La Turquie et l'hellénisme contemporain* (3e éd), Paris: Alcan, 1897, f. 6.

¹⁰³ E. Shehi, E. Çekrezi, E. Hasa, K. Velo, C. Abadie-Reynal, “Rezultatet e sondazheve arkeologjike...”, f. 243-248.

¹⁰⁴ E. Shehi, “Contributo sulla topografia di Dyrrachium ...”, f. 164.

vitet 20^{të} të shek. XX nuk na ka lejuar të kuptojmë nëse ka pasur një portë në të njëjtën hapësirë. Gërmimet arkeologjike kanë provuar se në shek. XII është realizuar një ndërhyrje fortifikuese¹⁰⁵. Më tej i janë mbështetur të tjera ndërtime, me përdorim civil si dhe janë vendosur varre.

Sipas tri hartave osmane (**Fig. 1**, nr. 32; **Fig. 2**, nr. 6; **Fig. 3**, nr. 13) “Porta e Skelës”, “Porta e jallisë” apo “Porta e kalasë” mbrohej nga bastioni S, një strukturë e gjerë, drejtkëndore, me kënde të prera 45°. Linja e jashtme ballore e bastionit është e pajisur me tre frëngji artilerie, ndërsa këndet e prera me nga një të tillë. Brinja lindore e bastionit nuk lidhet me kurtinën, por krijon një hapësirë të gjerë, emërtuar si “Porta e skelës/kalasë”. Porta skicohet me një parakorridor të shkurtër, pasuar nga pragu i derës. Më tej jepet një korridor i gjatë, i mbuluar. Në fundin e korridorit ka pasur një oborr të hapur. Drejt krahut verior hapej një tjetër portë që lidhej me pjesën e brendshme të kështjellës. Ajo ka pasur derë dykanatëshe, me hapje nga brenda. Drejt krahut jugor hapej një derë e cila lidhej me pjesën e brendshme të bastionit.

Hollësitë që përsëriten tek të dyja hartat me të njëjtën saktësi bëjnë që të mos dyshojmë në vërtetësinë e tyre. Burimet dokumentare, të përmendura më lart, largojnë çdo dyshim mbi ekzistencën e portës. Dallimi qëndron tek pozicioni tërësisht i ndryshëm që na japin fotografitë e fillimshkullit XX. Si mund të shpjegohen të tilla ndryshime? E vetmja mundësi duhet të lidhet me një evolucion topografik të kësaj porte brenda linjës juglindore, ç’ka bën të nevojshme të rishikojmë të gjithë historinë e Portës së Detit.

Në hartën e vitit 1571 nga Giovanni Francesco Camocio¹⁰⁶ këndi i skicimit të hartës, fatmirësisht paraqet këndin e bashkimit të mureve juglindor me atë jugperëndimor. Muri jugperëndimor fillon me një kullë drejtkëndore, tashmë të identifikuar prej nesh si kulla A1¹⁰⁷. Ngjitur me të fillon një kurtinë, e cila e lidh me një hyrje të fortifikuar në formën e

¹⁰⁵ E. Shehi, E. Çekrezi, E. Hasa, K. Velo, C. Abadie-Reynal, "Rezultatet e sondazheve arkeologjike...", f. 246-247, fig. 19.

¹⁰⁶ Harta mban të shënuar vitin 1571, ndërsa botimi i takon vitit 1574. Shih: Giovanni Francesco Camocio, *Isole famose, porti, fortezze, e terre maritime sottoposte alla Ser.ma Signoria di Venetia, ad altri Principi Christiani, et al Sig.or Turco*, Venecia: 1574.

¹⁰⁷ E. Shehi, “Evoluimi i linjës juglindore.....”.

një kulle drejtkëndore, ose Porta e Detit. Analiza e kujdesshme e formës që merr kjo kurtinë na tregon një detaj me shumë interes. Nuk kemi të bëjmë me një linjë të drejtë, por me një linjë të prerë që bashkon dy kullat.

Një pozicion i Portës së Detit sipas hartës së shek. XVI nuk përputhet me vendndodhjen e njohur në fotografitë e shek. XX. Përkundrazi, ajo duhet të korrespondojë me hyrjen dykanatëshe që hapet në muret e qytetit, e mbrojtur nga bastioni S, sipas hartave osmane. Në këtë rast nuk ka të shënuar një strukturë mbrojtëse në formë kulle në këtë vend. Një strukturë e tillë haset në brinjën lindore të bastionit S. Për këto arsye ne shikojmë si shpjegim të mundshëm rikonstruksionet e ndryshme realizuar tek hyrja e fortifikuar, njohur me emrin Porta e Detit, përgjatë periudhës osmane të administrimit të qytetit, që kanë krijuar realitete të reja. Porta mesjetare, e fortifikuar në formën e një kulle drejtkëndore, duket se ka qenë pak a shumë e ngjashme me imazhin e hartës së vitit 1571.

Pushtimi osman i ka gjetur fortifikimet e Durrësit të rrënuara tej mase. Për këtë arsye janë ndërmarrë masa rifortifikuese, tashmë të njohura dhe përmendura nga studiuesit¹⁰⁸. Mendojmë se një nga këto masa ka qenë realizimi i një bastioni të avancuar përpara Portës së Detit, duke i dhënë jetë bastionit S (faza e parë e tij). Moment shumë i rëndësishëm në historinë e fortifikimeve të Durrësit osman ka qenë pushtimi dhe plaçkitja nga ana e spanjollëve në vitin 1606, siç e kemi trajtuar edhe më parë. Pas kësaj ngjarjeje duket të jenë ndërmarrë një seri masash të rëndësishme fortifikuese, të cilat në linjën juglindore kanë qenë më shumë të dukshme. Tashmë besojmë se në këtë kohë është ndërtuar faza e dytë e bastionit S. Në krahun lindor të tij duhet të jetë kaluar nga një portë e thjeshtë në mure, në një hyrje të mbuluar, me korridor, dhe me një kat të dytë mbi të. Kjo portë është trajtuar me një parakorridor të shkurtër, pasuar nga pragu i derës.

Më tej, në thellësi, vazhdonte oborri i pambuluar, siç na tregojnë hartat osmane. Porta mesjetare e Detit me shumë mundësi duhet të ketë qenë e rrënuar aq sa të mos ndërmerreshin më meremetime, por të shembej e gjitha, duke ruajtur vetëm hyrjen në murin e qytetit. Ajo ka gjerësinë e kurtinës dhe dy ngushtime në secilin krah, në pjesën e jashtme

¹⁰⁸ Për një analizë të detajuar shih E. Shehi, “Evoluimi i linjës juglindore.....”.

të kurtinës. Kjo tregon se ka qenë portë dykanatëshe me hapje nga brenda. Jepet e gjitha e ngjyrosur me të verdhë, duke dëshmuar për një hapësirë të mbuluar. I njëjti shkak shpjegon arsyen se përse nuk e shikojmë në hartat osmane, por njëkohësisht na ngjason me fatin e kullës A1. Ky fortifikim i Portës së Detit, kombinuar me ndërtimin e kullës A dhe përforcimin e bastionit Q ka krijuar një sistem mbrojtës të jashtëzakonshëm dhe shumë efektiv. Tashmë emri Porta e Detit ka kaluar nga struktura mesjetare, e cila nuk ruhej më, tek porta monumentale e ngritur në brinjën e bastionit S.

Ky sistem ka vazhduar të funksionojë si i tillë deri në shek. XIX. Ndryshimet në teknologjinë ushtarake si dhe ndryshimet në raportin e forcave në Mesdhe mes Perandorisë Osmane dhe fuqive evropiane praktikisht kanë nxjerrë jashtë loje fortifikimet si mjete parësor i luftimit. Modeli modernizues i pallatit të Dollma Bahçe-së në kryeqendrën e perandorisë, i cili doli jashtë fortifikimeve tradicionale dhe në breg të detit, përkundër mënyrës se si ishte i vendosur pallati i vjetër i Top Kapisë nuk duhet të ketë qenë pa ndikim edhe në këtë pjesë të perandorisë.

Kështu edhe në rastin e Durrësit analogjia duket të ketë qenë pothuaj e njëjtë. Ngjitur me bastionin Q1 jepet një ndërtesë me pesë kthina dhe me një oborr të madh, identifikuar si “Eski Saray” ose sarajet e vjetra (**Fig. 1**, nr. 28). Njëra nga hapësirat e paraqitura në këtë strukturë u zbulua përgjatë gërmimeve të shpëtimit në vitin 2001. Bëhet fjalë për hapësirën drejtkëndore, me një apsidë në krahun lindor. Ajo kishte një dysheme të shtruar me tulla dhe në pjesën lindore një bazament kolone në nivelin e dyshemesë. Gjurmët e mureve ndarëse të paraqitura në hartën e parë të vitit 1865 (**Fig. 1**) nuk ishin të qarta, përveç një mbetjeje që ndante hapësirën apsidale nga kthina pranë. Së fundmi, jemi shprehur se këtu mund edhe të mendohej prania e një kishëze¹⁰⁹. Prova përfundimtare për një fakt të tillë për momentin nuk kemi. Megjithatë nuk do të ishte e çuditshme që pas pushtimit osman kishëza të jetë bërë pjesë e një strukture të re, me funksion tërësisht të ndryshëm. Në rastin konkret struktura e re identifikohet si Sarajet e Vjetra. Një emërtim i tillë është me shumë interes për t’u analizuar. Përse duheshin veçuar këto saraje nga të tjera që mund të ketë pasur në qytet, pronë e individëve të pasur? Duke pasur parasysh se harta në fjalë ka paraqitur vetëm struktura ushtarake

¹⁰⁹ M. Gaglione, E. Shehi, *Un documento angioino...*, f. 366.

dhe administrative publike, besojmë se Sarajet i takonin administratorit osman të qytetit. Sipas përshkrimeve të bëra nga Çelebi-u, komandantët e spahinjve dhe të jeniçerëve qëndronin në Elbasan. Kadiu i Durrësit qëndronte në Kavajë. Për rrjedhojë, ndoshta këto saraje ishin të dizdarit të kalasë. Vetëm pas kthimit të qytetit si qendër e sanxhakut me të njëjtin emër, do të emërohej një mytesarif në Durrës. Një tjetër pyetje që shtrohet është: përse konsideroheshin saraje “të vjetra” në vitin 1865? A duhet menduar ky term i lidhur me saraje të reja? Viti 1865 ishte viti i fundit kur qyteti, në pozicionin e kazasë qëndron nën vartësinë e Ohrit. Më 1866, po në pozicionin e kazasë, kalon nën vartësinë e Shkodrës. Shndërrimi në sanxhak dhe ndërtimi i rezidencës së mytesarifit do të ndodhë vetëm pas dy dekadash (shih më poshtë), çka përjashton mundësinë e lidhjes së sarajeve të reja me Konakun. “Sarajet e reja”, që mungojnë në hartë, në rolin e një rezidence të qeveritarit lokal, nuk mund të ishin larg qytetit apo mureve të tij. Për rrjedhojë, mendojmë se në momentin e rievimit të mureve të qytetit dhe ndërtesave administrative-ushtarake duhet të ketë qenë marrë vendimi për t’i dhënë jetë një ndërtimi të ri në rolin e “sarajeve”. Për këtë arsye, ndoshta, rievuesi i hartës, i cili ka qenë në dijeni të vendimeve mbi ndërtimet e reja (apo ndoshta vetë rievimi është bërë për këtë qëllim?), e ka emërtuar rezidencën e vjetër të administratorit si “sarajet e vjetra”.

Konaku i Durrësit, në formën monumentale që njihet nga fotot e qytetit dhe që shërbeu si rezidencë e Princ Vedit, ishte ngritur mbi bastionin S. Arkitekti duket të ketë vlerësuar disa aspekte topografike të qytetit të Durrësit, që ka përcaktuar këtë hapësirë si zonën më të mirë për ndërtim¹¹⁰. Për ndërtimin e tij doli jashtë funksioni Porta e Detit në pozicionin origjinal. Kjo hyrje u ruajt si porta e pasme e Konakut. Aspektet ndërtimore të kësaj ndërtese i kemi trajtuar më herët në mënyrë të detajuar¹¹¹. Ajo që mund të shtojmë në këtë artikull lidhet me datën e ndërtimit të Konakut. Ky konak nuk përmendet nga Hahn-i që e ka vizituar qytetin në vitin 1854. Nuk përmendet as nga Heuzey që e ka vizituar qytetin në vitin 1861, si dhe nuk gjendet në hartën e botuar prej tij. Në hartën osmane të bregdetit përballë skelave të vitit 1863, gjithashtu

¹¹⁰ Eduard Shehi, *Konaku i Durrësit*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: Botimet albanologjike, 2018, f. 234-237, mbi një trajtim të kësaj çështjeje.

¹¹¹ Po aty, f. 31-36.

mungon Konaku dhe është ende i dukshëm bastioni S. Për të njohur kohën e ndërtimit të tij u konsultuam me arkivin e Institutit të Historisë, ku ruhen telegramet e konsullit austro-hungarez të Durrësit. Një seri telegramesh mundësojnë të ndjekësh hap pas hapi peripecitë që ka pasur ngritja e kësaj ndërtese.

Konsulli austro-hungarez në Durrës njoftonte Ministrinë e Jashtme të vendit të tij më datë 20 tetor 1880 se po zbatohet me shpejtësi riparimi i ndërtesës qeveritare që ndodhej në gjendje shumë të keqe, me shpenzimet e mbuluara nga tregtarët vendas. Në të njëjtin raportim flitet edhe për mundësinë e ndërtimit të një gjykate të një shkalle më të lartë sesa ajo që kishte qyteti si dhe për projektimin e ndërtimit të Portit të Durrësit¹¹². Përderisa thuhet riparimi i ndërtesës, nënkupton një ngrehinë ekzistuese, e cila ishte në gjendje shumë të keqe. Për këtë arsye besojmë se riparimi në fjalë po zbatohet në ndërtesën e vjetër qeveritare, pasi e reja, siç do ta shikojmë në vazhdim ende nuk kishte filluar. Kjo ndërtesë e vjetër, besojmë ne, duhej të ishte *Eski Saray* – Sarajet e vjetra, të përmendura më lart.

Më 20 prill 1881, konsulli austro-hungarez në Durrës njoftonte se në fundin e vitit 1880 në Durrës ishte emëruar një mytesarif (i ardhur në qytet në muajin shkurt 1881) si dhe gjykata e rrethit (mudirllëku) ishte ngritur në gjykatë qeveritare (mytesarifllëku). Po në të njëjtin dokument përmendet borxhi prej 1800 lirash që tregtarët vendas duhej të jepnin për ndërtimin e godinës qeveritare (tregtarët e kishin kushtëzuar që ajo të bëhej pronë e bashkësisë)¹¹³. Fakti që përmendet ngritja e nivelit të gjykatës nënkupton edhe nevojën e ndërtimit të një ngrehine të re për të. Kjo datë, përkon me mbishkrimin e ruajtur në Muzeun Arkeologjik Durrës, ku dëshmohet ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë. Deri më sot nuk kemi arritur të identifikojmë dokumente arkivore të cilat të japin të dhëna të detajuara mbi këtë ndërtesë. Ne njohim praninë e saj nga fotografitë e fillimshkullit XX. Sipas mbishkrimit të përmendur, që gjendej mbi hyrjen e Pallatit të Drejtësisë, ky ndërtim ishte realizuar në vitin 1299

¹¹² *HHST.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 1-21-206. Telegram për konsullin von Haymerle mbi lajmet për ngritjen e një gjykate në Durrës, Durrës, 20 tetor 1880.

¹¹³ *Po aty*, Vj. 3-2-290. Telegram i Oculi-t në lidhje me përpjekjet e autoriteteve turke për të ngritur disa ndërtesa qeveritare në Durrës, Durrës, 20 prill 1881.

Hixhri (23.11.1881-11.11.1882)¹¹⁴. Në të përmendet edhe një “ruajtës [hafiz] i Kuranit”, Muhamed Beu. Sipas të gjitha gjasave, Hafiz Muhamed Beu është i njëjti person me Hafiz Mehmed apo Hafis Mehmet Efendiu që e hasim në telegramet e konsullit austro-hungarez. Gjithashtu, ai njihet si Hafiz Mehmed Pasha, mytesarif i sanxhakut të Durrësit, i cili përmendet për fushatën e një kompleksi ndërtimesh sipas sallnamesë së Shkodrës (shih më lart). Ndërkohë, data e mbishkrimit duhet të lidhet me hedhjen e themeleve, jo me përfundimin e punimeve të saj. Këtë e themi, pasi në vazhdim do të shikojmë rrjedhën e ngjarjeve që ka pasur ndërtimi i Konakut dhe koha e nevojshme për përfundimin e saj.

Më datë 7 shtator 1881 i njëjti konsull njoftonte se tregtarët ishin tërhequr nga propozimi për të dhënë koston e ndërtimit të ndërtesës qeveritare duke bërë një propozim tjetër tregtar për financimin e saj. Me interes në këtë informacion është një pasazh ku thuhet se “*shpenzimet administrative vjetore të kësaj bashkie që u krijua në vitin 1878...*”¹¹⁵.

Më datë 2 nëntor 1881, konsulli austriak bën me dije se ndërtimi i godinës qeveritare kishte filluar më 29 shtator 1881 dhe se punimet i drejtonte një mjeshtër nga Dibra. Tregtarët vendas kishin rënë dakort të jepnin një paradhënie për të vazhduar punimet në fjalë, shumë me të cilën mund të punohej për 2 muaj e gjysmë¹¹⁶.

Më datë 5 korrik 1882, konsulli austro-hungarez ka dërguar një njoftim, i cili në fakt krijon vështirësi për interpretim. Citojmë përkthimin e dokumentit që ndodhet në arkivin e Institutit të Historisë: “*Tekniku i ndërtimit italian i cili kishte ardhur nga Monopoli dhe kishte ndërtuar para ca kohe së bashku me 10 muratorë, një ndërtesë të bukur me gurë për tregtarin e pasur turk Terko, në bregdet karshi ndërtesës qeveritare të sapopërfunduar, shqyrtoj dije në kërkesë të guvernatorit mundësinë e riparimit të urës mbi lumin Erzen dhe të paraqesë pastaj një projekt dhe preventivin*”¹¹⁷. Nëse do të bëhej fjalë për ndërtesën qeveritare, punimet e së cilës kishin filluar më 29 shtator 1881, nënkupton një kohëzgjatje ndërtimi prej afro 7 muajsh. Ndërkohë që

¹¹⁴ M. Kiel, *Arkitektura osmane...*, f. 143-144.

¹¹⁵ *HHSt.A.P.A.A* në *AiH*, Vj. 3-4-419.

¹¹⁶ *Po aty*, Vj. 3-2-300. Telegram i Oculi-t për ministrin mbi kërkesën e guvernatorit osman të Durrësit për të marrë hua prej tregtarëve të qytetit, 2 nëntor 1881.

¹¹⁷ *Po aty*, Vj. 32-1-103. Telegram për kontin von Karolky rreth aktiviteteve ndërtuese në qytetin e Durrësit, Durrës, 5 korrik 1882.

dokumentet e mëvonshme tregojnë se punimet vazhdonin dhe ndërtesa nuk kishte përfunduar ende. Më 12 nëntor 1884 i njëjti konsull njofton se tregtarët e qytetit nuk kishin huazuar shumën e nevojshme për të përfunduar punimet e ndërtesës së re¹¹⁸. Deri në vitin 1884 ndërtesa, e cila kishte avancuar në punime, ende nuk kishte përfunduar.

Besojmë se një ndërhyrje në shkallë kaq të gjerë ndërtimore në Durrës përtej mundësive vendore ka qenë pjesë e një procesi të përbashkët administrativ, të miratuar dhe të financuar nga kryeqyteti i perandorisë, për kthimin e Durrësit në një qendër funksionale administrative, e lidhur ngushtë me shpalljen sanxhak në vitin 1881. Ndërtimi i këtij kompleksi në kohën e shndërrimit në sanxhak të Durrësit me shumë mundësi është i lidhur me ngjarjet më të gjera të Krizës Lindore por dhe të Lidhjes së Prizrenit në veçanti. Me anë të këtyre reformave administrative por dhe ndërtimore, Porta e Lartë duket të jetë përpjekur të krijonte një klimë të re me popullsinë shqiptare në mënyrë që ta tërhiqte drejt një gjendje më paqësore nëse kihen parasysh lëvizjet e mëdha kombëtare dhe ushtarake që shoqëruan Lidhjen. Ky moment i ri në marrëdhëniet midis Portës së Lartë dhe popullit shqiptar duhet të ketë shërbyer si katalizator për përshejtimin e vënies në zbatim të ndërtimeve administrative nëse kihet parasysh se nga hartat e sipërpërmendura duket qartë të paktën pjesërisht planifikimi i ndërtimeve të rëndësishme përgjatë pjesës bregdetare të fortifikimeve otomane të Durrësit.

Cilado qoftë arsyeja apo arsyet që çuan në ndërtimin e këtij kompleksi të rëndësishëm administrativ është e qartë se ato sollën ndalimin e përdorimit për qëllime ushtarake të bastionit S si dhe riorientimin e mënyrës së hyrjes për në qytet nga ana e detit. Një zgjidhje e tillë do të linte qytetin pa portën kryesore që e lidhte me portin. Ashtu sikurse në rastin e dublimit të kullave A – A1 edhe në këtë rast është kaluar në një zhvendosje strukturash. Ngjitur me bastionin S – tashmë Konaku i mytesarifit, u ngrit një portë e re, e fortifikuar, me një korridor

¹¹⁸ Është e vështirë të kuptohet se për cilën ndërtesë bëhet fjalë saktësisht. Relacioni në fjalë i referohet një kompleksi që do të ngrihej, pjesë e të cilit do të ishte edhe godina e bashkisë. Projekti i madh kapte vlerën e 300 mijë lirave dhe, mosmarrja e huasë duket se e kishte mërzitur guvernatorin, i cili në vitin 1884 i gëzohej faktit që atë vit kishte patur një prodhim të mirë të ullinjve, me shitjen e të cilëve mund të sigurohej edhe një pjesë e shumës së nevojshme për ndërtimin e kompleksit në fjalë. Shih, *po aty*, Vj. 35-52.

të mbuluar dhe një kat të dytë mbi të. Kjo lloj strukture është shumë e ngjashme me ato të skicuara në hartat osmane, tek brinja veriore e bastionit S. Për më tepër, kësaj porte i është ngjitur edhe emri i vjetër, Porta e Detit. Vetëm në këtë formë do të kishin shpjegim të gjitha të dhënat që kemi arritur të mbledhim.

Harta e parë e njohur gjerësisht ndër arkeologët shqiptarë ka qenë ajo e përpunuar nga Laloy dhe botuar nga Heuzey dhe Daumet¹¹⁹. Fatkeqësisht, harta franceze në këtë pjesë të fortifikimeve nuk është e detajuar, ç'ka ka krijuar vështirësi në interpretim më herët, përfshirë këtu edhe botimet shqiptare. Diçitura "Porta Yali" vendoset pranë pozicionit të skelës, e zhvendosur në raport me bastionin S. Ky pozicion ka bërë që të vlerësohet vendndodhja e saj e ngjashme me atë të fotografive të fillimshkullit XX. Ndërkohë, bastioni S jepet me një hapësirë boshe në qendër, e ngjashme me oborrin e brendshëm të Konakut të mytesarifit. Prapa saj jepet një tjetër strukturë drejtkëndore në planimetri, gjithashtu me hapësirë boshe në qendër, interpretuar si Pallati i Drejtësisë. Në përshkrimin në tekst, studiuesit francezë mjaftohen me një fjali¹²⁰. Për këto arsye kanë ardhur të gjitha keqinterpretimet mbi formën, vendosjen dhe planimetrinë e Portës së Detit. Si rrjedhim duke u nisur nga pozicioni dhe kronologjia e ndryshme e këtyre portave, lind nevoja që ato të emërtohen në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra në mënyrë që të largojmë pështjellimet e mundshme në lidhje me identifikimin përkatës në të ardhmen. Kështu, ne propozojmë që sistemi i hyrjes dhe porta e vendosur në brinjë të bastionit S të emërtohet si Porta e Detit R1 dhe porta më e hershme e vendosur direkt në muret e qytetit para ndërtimit të bastionit S, të emërtohet Porta e Detit R2.

Bastioni S. Kjo strukturë është emërtuar nga Rey me germën S¹²¹. Edhe nga Heuzey përmendet por nuk e trajton pasi e quante ndërtim modern¹²². Asnjë autor tjetër nuk e ka përshkruar apo trajtuar. Rey, nga ana tjetër, ka parë të ndërtuar mbi të Konakun e mytesarifit osman të qytetit. Fakti që e ka bërë pjesë të fortifikimeve, duke i dhënë edhe një

¹¹⁹ L. Heuzey, H. Daumet, *Mission archéologique...*, harta H.

¹²⁰ *Po aty*, f. 355.

¹²¹ L. Rey, "Les remparts de Durazzo...", f. 45.

¹²² L. Heuzey, H. Daumet, *Mission archéologique...*, f. 355.

emërtim, por pa e trajtuar atë si elementët e tjerë fortifikues, duhet lidhur me identifikimin e këtij bastioni si ndërtim modern.

Tek harta e dytë osmane emërtohet si “Bastioni mbi portë” dhe megjithëse planimetria e përgjithshme e saj është e saktë, pozicionohet gabimisht në vijë të drejtë me linjën jugperëndimore (**Fig. 2**, nr. 5). Tek harta e tretë ka një paraqitje shumë të stilizuar dhe emërtohet vetëm hyrja e qytetit, “Porta e kalasë” (**Fig. 3**, nr. 13). Ndërsa në hartën e parë osmane emërtohet “Bastioni i ulët” (**Fig. 1**, nr. 33). Ky emërtim përkon tërësisht me vlerësimin që kemi bërë më parë mbi të¹²³. Ky bastion skicohet si një strukturë e gjerë, drejtkëndore, me kënde të prera 45°. Linja e jashtme ballore e bastionit është e pajisur me tre frëngji artilerie, ndërsa këndet e prera me nga një të tillë. Brinja perëndimore e tij lidhet me kurtinën, me kënd të drejtë. Ky bastion ishte i avancuar drejt bregut të detit dhe me lartësi më të vogël sesa muri kryesor fortifikues. Ai është gërmuar pjesërisht nga ana jonë në vitin 2017 dhe përshkruar me detaje¹²⁴. Kemi shprehur mendimin se mundësitë për datim janë dy: faza e parë e bastionit mund të datohet në vitin 1565 ose para vitit 1606, ndërsa faza e dytë, masive për nga përmasat dhe shumë më cilësore, datohet pas vitit 1606¹²⁵. Tek harta e tretë mbi muret e bastionit ngrihen gjoksore me frëngji pushke në mesin e tyre, si edhe një kabanare e vogël (**Fig. 3**).

Struktura ushtarake brenda mureve

Trajtimi i elementëve mbrojtës të qytetit ka qenë lidhur gjithmonë me muret fortifikuese dhe me kështjellën në kuotën 59 m. Asnjëherë nuk ka qenë i mundur trajtimi i strukturave të tjera ushtarake që nuk lidheshin direkt me muret fortifikuese. Për këtë arsye kjo çështje merr një rëndësi të veçantë.

Në pjesën e brendshme të fortifikimeve deri më sot ne kemi njohur ekzistencën e një muri perpendikular, i cili lidhte linjën jugperëndimore me atë veriore duke krijuar një oborr para kështjellës. Ky mur

¹²³ E. Shehi, “Konaku i Durrësit...”, f. 230, 232-233, fig. 77.

¹²⁴ E. Shehi, E. Çekrezi, E. Hasa, K. Velo, C. Abadie-Reynal, “Rezultatet e sondazheve arkeologjike...”, f. 227-236.

¹²⁵ Për paraqitjen më të gjatë të gërmimeve dhe datimeve shih E. Shehi, E. Çekrezi, E. Hasa, K. Velo, C. Abadie-Reynal, “Rezultatet e sondazheve arkeologjike...”, f. 227-260.

perpendikular është skicuar në hartën e Laloy-t, por në pothuaj të gjitha studimet është lënë pas dore, ose për mungesë të dhënash, ose sepse mund të jetë vlerësuar si jo i vërtetë. Hartat osmane në trajtim jo vetëm e japin të vërtetë praninë e këtij muri, por edhe na dëshmojnë se ka pasur dy të tillë që lidhnin dy linjat e fortifikimeve dhe krijojnë dy oborre, si hapësira ndarëse mes qytetit dhe kështjellës. Për efekt studimor, këto mure do t'i emërtojmë sipas kullave që kanë pranë: muri E-K si dhe muri EF-J.

Oborri i parë krijohet në pjesën e poshtme të kështjellës, mes dy mureve perpendikularë me linjat fortifikuese. Muri i parë E-K, kishte formën e germës L dhe ishte i pajisur me dy hyrje, të vendosura në ekstremet e tij. Nëpërmjet këtyre hyrjeve realizohej lidhja me qytetin. Muri i dytë, EF-J, trajtohej si një linjë e thjeshtë dhe e drejtë. Edhe ky mur kishte gjithashtu dy porta komunikimi, të vendosura po ashtu në ekstreme. Një pozicionim i tillë i hyrjeve mund të lidhet me aspektet mbrojtëse. Mbrojtja e tyre mund të ishte më efikase duke pasur pranë edhe linjat kryesore të fortifikimeve.

Përmasat dhe forma e oborrit të parë paraqiten të ndryshme mes hartave (**Fig. 1**; **Fig. 2**). Duke qenë se harta e parë është më e saktë, besojmë se duhet marrë ajo për bazë në lidhje me përshkrimin. Këtu forma e oborrit jepet si një shirit i gjatë dhe i ngushtë. Brenda saj vendoset vetëm një ndërtesë, emërtuar si “Karakoll” (**Fig. 1**, nr. 19). Në hartën e dytë (**Fig. 2**) janë vendosur një seri linjash të holla, që tregojnë pjerrtësinë e terrenit, pa asnjë ndërtesë.

Oborri i dytë krijohet mes murit të dytë perpendikular, EF-J, dhe kurtinës F-I. Në hartën e parë, territori i këtij oborri jepet në formën e një trapezi (**Fig. 1**), me shtrirje më të madhe se oborri i dytë. Tërësisht të kundërta jepen përmasat në hartën e dytë (**Fig. 2**). Brenda oborrit të dytë, harta e parë vendos një ndërtesë me formë komplekse, të gjatë, me disa kthina, emërtuar “Zyrë xhandarmërie” dhe “Vendi ku do të ndërtohet shtabi ushtarak” (**Fig. 1**, nr. 14-16). Një ndërtesë më e vogël identifikohet si “Shtypshkronjë” (**Fig. 1**, nr. 17). Tek harta e dytë shënohet vetëm një ndërtesë, me pozicion të ndryshëm, emërtuar “Kazerma e topçinjve” (**Fig. 2**, nr. 28). Këto dallime na bëjnë të mendojmë se harta e parë është më e vonë dhe paraqet jo vetëm gjendjen në terren por edhe ngrehina që ishin vlerësuar të ngriheshin – shtabin ushtarak, ndërkohë që ka eliminuar ndërtime që duheshin prishur ose ishin prishur – kazermën e topçinjve apo Sarajet e Vjetra të paraqitura në hartën e dytë.

Ndërtesat e tjera ushtarake janë skicuar ngjitur ose pranë me linjën juglindore të fortifikimeve. Brenda bastionit Q janë vendosur disa hapësira, të cilat, fatkeqësisht, nuk janë identifikuar për sa i përket funksionit të tyre.

Një ndërtesë e vogël, pranë hyrjes lindore të qytetit (Porta e Detit), nuk emërtohet. Sipas hartës janë katër kthina të vogla. Pozicioni ku gjendet, besojmë se duhet parë i lidhur me aspektet ushtarake ose, mund të ishte një stacion policor pranë portës, si ato që ishin pranë Portës së Madhe.

Në krahun tjetër, pranë kullës A ishin vendosur disa struktura që funksiononin së bashku dhe lidheshin me anë të një oborri të brendshëm, të shkëputur nga pjesa tjetër e qytetit. Bëhet fjalë për katër kthina të mëdha, emërtuar “Hambari i topçinjve”, “Kazermë” dhe “Verandë” (**Fig. 1**, nr. 34-36). I gjithë ky kompleks lidhet me artiljerët, të ngarkuar për mbrojtjen e bregdetit dhe të skelave. Pjesë e këtyre ngrehinave duhej të kenë qenë edhe ato të përmendura tek harta e dytë, “Kazermë” dhe “Kuzhina” (**Fig. 1**, nr. 7, 9).

Këto të dhëna dëshmojnë se garnizoni osman i qytetit ishte përqendruar në dy sektorë, në kështjellën mbi kuotën 59 m dhe pranë linjës juglindore të fortifikimeve. Duke krahasuar numrin e ndërtesave me funksion ushtarak është e qartë se rëndësi më të madhe kishte kështjella e sipërme. Aty ishte përqendruar garnizoni dhe magazinat ushtarake. Në këtë formë mbahej nën kontroll pika më e lartë e qytetit, forcat ushtarake ishin të sigurta brenda mureve dhe mund të kontrollohej situata në të gjithë territorin me lehtësi. Hapësira e dytë lidhej me kontrollin e skelave dhe të bregdetit. Këto struktura ishin integruar ose ishin vendosur ngjitur me muret fortifikuese.

Sistemi rrugor

Të dhënat për rrugët vijnë kryesisht nga harta e dytë osmane (**Fig. 2**), nga harta topografike e vitit 1928 (**Fig. 7**), si dhe nga një foto ajrore e vitit 1918 që disponojmë (e pabotuar), realizuar nga Marina Luftarake Italiane. Hahn i kushton vetëm dy fjali sistemit rrugor të qytetit. Më tej, asnjë informacion nuk kemi arritur të gjejmë. Për këtë arsye jemi të detyruar të interpretojmë të dhënat e hartave dhe të fotos ajrore të vitit 1918.

Tek harta e dytë pjesa e brendshme e qytetit paraqitet me disa blloqe banimi, të paraqitura në forma gjeometrike të çrregullta dhe të ngjyrosura me rozë. Ato ndahen mes tyre me breza ngjyre të bardhë, që paraqesin rrugët. Megjithëse në shikim të parë duket se ka një mungesë totale organizimi të sistemit rrugor, një analizë e kujdesshme nxjerr në pah tri prirje kryesore në orientimin e rrugëve.

Prirja e parë lidhet me ndjekjen e pjesës së brendshme të kurtinave të fortifikimeve. Kështu janë krijuar dy rrugë, që fillojnë nga pjesa e pasme e linjës juglindore (pranë “Portës së skelës”, pra portit) dhe zgjaten pothuaj paralel me linjën jugperëndimore në njërin krah, dhe linjën lindore e veriore në krahun tjetër.

Të tilla rrugë do t’i konsideronim normale, pasi lehtësonin lëvizjen e garnizonit sa më shpejt, në raste urgjencash, drejt pikës së rrezikuar nga sulmuesit. Ndoshta, mund të shikojmë në to një vazhdimësi të urbanistikës së periudhës mesjetare, vazhduar përgjatë periudhës osmane, sigurisht me ndryshimet përkatëse.

Prirja e dytë vihet re tek rrugët që ngjiten nga linja juglindore (pranë “Portës së skelës”, pra portit) drejt pjesës së sipërme të qytetit. Janë tre akse rrugore të tilla, të cilat ruajnë orientimin kryesor veri-jug, me shmangie të lehta. Nga këto tri rrugë ajo qendrore duhet të kishte pikënisjen nga Porta e Detit. Ajo përkon me “Rrugën e pazarit” (*Bazarstrasse*) të përmendur nga Hahn¹²⁶. Pozicion identik e hasim edhe tek harta e botuar nga Heuzey dhe Daumet. Të tria këto akse kanë vazhduar deri në dekadat e para të shek. XX, para realizimit të punimeve masive për riplanifikimin urban. Pas hapjes së rrugës kryesore që komunikon me portin, në vitet 30-të të shekullit të kaluar, e cila vazhdonte pak a shumë në aksin e rrugës qendrore të hartave osmane, mbijetuan në gjurmën e vjetër dy rrugët anësore. Njëra që fillon pranë kullës A dhe vazhdon drejt veriut, në mes të lagjeve, dhe harkon pranë amfiteatrit. Rruga tjetër fillon pranë vendpozicionimit të Portës së Detit në shek. XX dhe me një kthesë të gjerë përfundon prapa bashkisë së qytetit, ku dikur gjendej Porta e Madhe.

Prirja e tretë vihet re në rrugët diagonale, ato që fillojnë nga pjesa e brendshme e linjës jugperëndimore dhe drejtohen në akse të çrregullta drejt lindjes apo verilindjes. Këto rrugë janë më të shumta në numër dhe

¹²⁶ G. Hahn, *Albanesische Studien...*, f. 75.

kanë orientime jo të njëtrajtshme. Të vetmet specifika që mund të dallojmë në vendosjen e tyre lidhen me portat që njohim sot në linjën jugperëndimore përkundrejt atyre lindore dhe veriore.

Duket sikur dy nga rrugët që fillojnë nga pjesa e brendshme e linjës jugperëndimore kanë pikënisje nga portat në kurtinat A-B dhe D-E. Një rrugë e tretë ka pikënisje saktësisht nga pjesa ku kurtina ka një prerje moderne, pranë kullës C.

Në krahun e kundërt, në pjesën e brendshme të kurtinave lindore dhe juglindore, shtrihet një lagje masive, pa rrugica ndarëse. Në këto dy linja muresh nuk njihet ekzistenca e asnjë porte, përveçse “Portës kryesore”.

Përfundime

Qëllimi i këtij artikulli lidhet me trajtimin e aspekteve kryesore topografike ushtarake të qytetit të Durrësit gjatë periudhës osmane. Këtë synim u përpoqëm ta arrijmë nëpërmjet kombinimit të të dhënave të marra nga burime të ndryshme. Në raport me fortifikimet e qytetit, tashmë është e qartë se evolucioni i tyre është shumë më i ndërlikuar sesa është menduar. Gjithashtu, tashmë kemi prova të qarta se investimet e Perandorisë Osmane tek fortifikimet kanë qenë të konsiderueshme. Fatkeqësisht të tilla studime dhe analiza kanë munguar dhe për rrjedhojë jo vetëm ndërtimet e kësaj periudhe janë shpërfillur tërësisht por edhe kanë krijuar keqkuptime apo keqpërdorime të konsiderueshme. Evolucioni i fortifikimeve juglindore paraqet rastin më të veçantë dhe më kompleks. Kjo pjesë e fortifikimeve ishte brezi i parë i mbrojtjes ndaj sulmeve nga deti. Duke llogaritur faktin se Perandoria Osmane nuk ndjente asnjë rrezik nga prapatoka, por vetëm nga deti, është e logjikshme që të synohej kthimi i ballinës bregdetare në një sistem mbrojtës të papushtueshëm.

Oborret para kështjellës në kodrën 59 m synonin përforcimin e territorit më të mbrojtur dhe të hapësirës së fundit ku garnizoni osman mund të rezistonte në rast se sulmuesit pushtonin qytetin. Hapësira e vogël e kështjellës dhe numri i kufizuar i ushtarëve që mund të vepronin në të qartësisht nuk mund të mjaftonte për t'i rezistuar një rrethimi të gjatë. Kjo mbrojtje duhet të jetë përllogaritur që të zgjaste mjaftueshëm sa të vinin përforcime nga prapatoka. Pikërisht, duke vendosur dy oborre që i paraprinin kështjellës, zgjatej koha që sulmuesit do të kishin nevojë për të arritur deri tek kështjella. Ndërsa për mbrojtësit fitohej kohë e vyer.

Nga ana tjetër, skicimi i organizimit të qytetit brenda mureve dëshmon se ka pasur një vazhdimësi urbane nga qyteti mesjetar në atë osman edhe pse në përmasa modeste. Më pas, këto aspekte bazë të organizimit të qytetit janë fosilizuar, duke u imponuar edhe në periudhën moderne, në linjat kryesore të zhvillimit të qytetit. Dëshmia më e qartë janë rrugët, veçanërisht ato që ndjekin akset veri-jug. Tashmë kemi treguar qartësisht se pavarësisht evolucionit të fortifikimeve në linjën juglindore, ka pasur një vazhdimësi mbivendosjesh që nga Antikiteti i Vonë. Rrugët e skicuara në hartën e dytë kanë si pikënisje territorin pranë kësaj linje muresh. Ato me siguri ndjekin aksin e rrugëve mesjetare.

Duke ruajtur organizimin urban mesjetar, edhe vazhdimësia e qytetit osman ka ruajtur po ato parime zhvillimore. Sigurisht, duke pësuar ndryshime të evolucionit të banesave, që lidhet me shumë arsye, kryesisht me pronësinë e truallit. Këto të dhëna hedhin poshtë përshkrimin e Idris Bitlisit se pas pushtimit të Durrësit, osmanët rindërtuan gjithçka brenda qytetit¹²⁷. Vazhdimësia urbane tregon të kundërtën.

Investimet osmane për ndërtesa administrative në funksion të portit, janë dëshmi e ringjalljes së qytetit dhe tregtisë së tij. Ndërkohë, këto ndërtime mund të konsiderohen më së shumti rinovime të ndërtesave më të hershme apo në rastin më të mirë ndërtime të reja duke prishur ato më të vjetrat. Për rrjedhojë, mund të interpretojmë këto ndërhyrje të pas vitit 1863 si masa të ndërmarra shumë vonë, në një qytet i cili kishte filluar të ringjallej disa dekada më parë, edhe pse nën hijen administrative të qendrave të tjera.

Lista e figurave

Fig. 1 Hartë osmane e vitit 1865, sipas *ARSHIV 2016*.

Fig. 2 Harta osmane e shek. XIX, sipas *ARSHIV 2016*.

Fig. 3 Harta osmane e vitit 1863, sipas *ARSHIV 2016*.

Fig. 4 Planimetri e qytetit të Durrësit, sipas HEUZEY, DAUMET 1876.


Ripunuar nga G. Naessens.

Fig. 5 Planimetri e fortifikimeve të Durrësit. Ripunuar sipas REY 1925 nga E.Shehi.

Fig. 6 Harta e fortifikimeve të Durrësit, krijuar duke ndërthurrur rievimet në terren me të dhënat nga hartat osmane. Punuar nga M.Nushi dhe E.Shehi.

Fig. 7 Harta topografike e vitit 1928, Arkivi Teknik Qendror, Tiranë.

¹²⁷ *Lufta shqiptaro-turke...*, f.125, 178-182.



*Fig. 1 Hartë
osmane e vitit
1865, sipas ARŞIV
2016*

- | | | |
|--|--|---------------------------------|
| Nr. 1 - Bastion. | Nr. 16 - Vendi ku do të ndërrohet shtabi ushtarak. | Nr. 31 - Teqe. |
| Nr. 2 - Kazerma e topçinjeve. | Nr. 17 - Shtypshkronjë. | Nr. 32 - Porta e skelës. |
| Nr. 3 - Bastion. | Nr. 18 - Bastioni i flamurit. | Nr. 33 - Bastioni i ulët. |
| Nr. 4 - Bastion. | Nr. 19 - Karakoll. | Nr. 34 - Hambari i topçinjeve. |
| Nr. 5 - Llogore (pozicion). | Nr. 20 - Porta e varoshtit. | Nr. 35 - Kazerme. |
| Nr. 6 - Porta (jarash?). | Nr. 21 - Karakoll. | Nr. 36 - Verandë. |
| Nr. 7 - Bastioni (?). | Nr. 22 - Karakoll. | Nr. 37 - Bastioni venecian. |
| Nr. 8 - Depo municionesh. | Nr. 23 - Sahati. | Nr. 38 - Bastioni i Ibrahimit. |
| Nr. 9 - Bastion. | Nr. 24 - Karakoll. | Nr. 39 - Bastioni i Muradit. |
| Nr. 10 - Kazerme. | Nr. 25 - Depo municionesh. | Nr. 40 - Hendek. |
| Nr. 11 - Hambari i topçinjeve. | Nr. 26 - Bastioni i eminit (inspektor). | Nr. 41 - Bastioni i fikut. |
| Nr. 12 - Zabitë (ushtri, xhandarmeri). | Nr. 27 - Miri mazasi (hapësirë shtetërore ?). | Nr. 42 - Bastioni i Seferdinit. |
| Nr. 13 - Depo municionesh. | Nr. 28 - Saraji i vjetër. | Nr. 43 - Rrethim. |
| Nr. 14 - Zyrë xhandarmërie. | Nr. 29 - Dogana. | |
| Nr. 15 - Zyrë xhandarmërie. | Nr. 30 - Karantinë. | |



Fig. 2 Harta
osmane e shek.
XIX, sipas
ARŞIV 2016

Nr. 1 – Kalaja e Durrësit.
Nr. 2 – Bastion.
Nr. 3 – Bastion.
Nr. 4 – Bastioni venecian.
Nr. 5 – Bastioni mbi portë.
Nr. 6 – Porta e jallisë (qoshkut, viles).
Nr. 7 – Kazermë.
Nr. 8 – Bastioni kryesor.
Nr. 9 – Mencion.
Nr. 10 – Porti.
Nr. 11 – Urë.

Nr. 12 – Liqen.
Nr. 13 – Rruga për Kavajë.
Nr. 14 – Lagja kopte.
Nr. 15 – Kulla e sahatit.
Nr. 16 – Çarshia (tregu, pazari).
Nr. 17 – Cezmë.
Nr. 18 – Kazermë.
Nr. 19 – Porta e madhe (kryesore).
Nr. 20 – Portë.
Nr. 21 – Bastion.
Nr. 22 – Gjiri venecian.

Nr. 23 – Kalaja e brendshme.
Nr. 24 – Depo municionesh.
Nr. 25 – Kodra e ullinjve.
Nr. 26 – Saraji i vjetër.
Nr. 27 – Bastioni mbi portë.
Nr. 28 – Kazerma e topçinjve.
Nr. 29 – Hendek.
Nr. 30 – Baççe (kopshte, në kuptimin e parkut).
Nr. 31 – Arë.
Nr. 32 – Moçal.
Nr. 33 – Eshhtë me përmasa rreth 80 masë bujqësore osmane.




Fig. 3 Harta osmane e vitit 1863, sipas ARSHIV 2016

- Nr. 1 - Kalaja e Durrësit.
 Nr. 2 - Pamje e ndërtesës që do të ngrihet.
 Nr. 3 - Pamje e kati të epërm të hapësirës së doganës.
 Nr. 4 - Abdest'hane (vend për marrje abdesti).
 Nr. 5 - Sotia (Ballkon i gjërë).
 Nr. 6 - Vend për bërijen e kafesë.
 Nr. 7 - Hambar.
 Nr. 8 - Zyre tjetër.
 Nr. 9 - Zyra e nëpunësve.
 Nr. 10 - Hapësirë e pjesëve përbërëse të kalasë.
 Nr. 11 - Plani i ndërtesës.
 Nr. 12 - Plani i magazinave të vjetra ku do të ndërtohet dogana.
 Nr. 13 - Porta e kalasë.
 Nr. 14 - Medreseja e cila gjendet në afërsi të hapësirës me përmasa 14 zira.
 Nr. 15 - Hambar.
 Nr. 16 - Kati i poshtëm do të jetë zyrë sekretarie.
 Nr. 17 - Karantina që gjendet përpara hapësirës me përmasa 14 zira.
 Nr. 18 - Hapësirë me përmasa 60 zira.
 Nr. 19 - Porta e skelës.
 Nr. 20 - Ndërësë prej hekuri që duhet ndërtuar përpara doganës.
 Nr. 21 - Skela e karantinës.
 Nr. 22 - Skela me gjerësi 5 dhe gjatësi 45 zira.
 Nr. 23 - Skela e vjetër.




Fig. 4 Planimetri e qytetit të Durrësit, sipas HEUZEY, DAUMET 1876. Ripunuar nga G. Naessens




Fig. 5 Planimetri e fortifikimeve të Durrësit. Ripunuar sipas REY 1925 nga E.Shehi




Fig. 6 Harta e fortifikimeve të Durrësit, krijuar duke ndërthurur rilevimet në terren me të dhënat nga hartat osmane. Punuar nga M.Nushi dhe E.Shehi




Fig. 7 Harta topografike e vitit 1928, Arkivi Teknik Qendror, Tiranë

S u m m a r y

OBSERVATIONS ON DURRËS FORTIFICATIONS IN THE OTTOMAN PERIOD

The aim of this paper is related with the treatment of the main military topographic aspects of the city of Durrës during the Ottoman period. This goal we tried to achieve through combining the data taken from different sources. In relation with the city's fortifications, it's already clear that their evolution is more complicated than has thought. Also, already we have clear evidences that the investments of the Ottoman Empire on fortifications have been considerable. Unfortunately such studies and analyzes lacked and as consequence not only the constructions of this period have been totally ignored, but also have created considerable misunderstandings and misuse.

From the other part, the design of the city organization within the walls, proves that has had an urban continuity from the medieval city to the Ottoman era even why on modest dimensions. After, these basic aspects of the city organization are fossilized, also imposing to the modern age, in the main lines of the city development. The clearer evidence are the roads, especially those who follow the north-south axes. Already we have clearly shown that nevertheless the evolution of fortification in the southeastern line, there has been a continuity of a superpose established since the Late Antiquity. The designed roads in the second map have as starting point the territory near this line of walls. Those for sure follow the axes of the medieval roads.

Preserving the medieval urban organization, also the continuity of the Ottoman city has preserved the same development principles. Of course, were the enduring changes of the dwellings evolution, connected for many reasons, mainly with the land property. These data reject the description of Idris Bitlisi that after the occupation of Durrës, the Ottomans rebuild everything within the city. The urban continuity shows the opposite.

